



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

RAPORTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS

Vlera për para në prokurimet e centralizuara, pjesa e dytë

Prishtinë, korrik 2021

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Misioni ynë është që përmes auditimeve cilësore të fuqizojmë llogaridhënien në administratën publike për përdorimin efektiv, efikas dhe ekonomik të burimeve kombëtare. Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien e institucioneve publike duke ofruar bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate të audituar. Në këtë mënyrë, ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Ky auditim është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA 3000¹) si dhe me praktikat e mira evropiane.

Auditimet e performancës të ndërmarra nga Zyra Kombëtare e Auditimit janë shqyrtime objektive dhe të besueshme që vlerësojnë nëse veprimet qeveritare, sistemet, operacionet, programet, aktivitetet ose organizatat veprojnë në përputhje me parimet e ekonomisë², efikasitetit³ dhe efektivitetit⁴ dhe nëse ka vend për përmirësim.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me përmbajtjen e raportit të auditimit “Vlera për para në prokurimet e centralizuara, pjesa e dytë” në konsultim me Ndihmës Auditorin e Përgjithshëm, Vlora Spanca, e cila e ka mbikëqyrur auditimin.

Ekipi që e realizoi këtë raport:

Fatlinda Ramosaj, Udhëheqës i auditimit

Arben Selimi, Udhëheqës i ekipit

Armin Bushati, Anëtar i ekipit

¹ SNISA 3000 Standardet dhe udhëzimet për auditimin e performancës bazuar në Standardet e Auditimit të ONISA-s dhe përvoja praktike

² Ekonomia –Parimi i ekonomisë nënkupton minimizimin e kostos së resurseve. Resurset e përdorura duhet të jenë në dispozicion me kohë, në sasi dhe cilësi të duhur dhe me çmimin më të mirë

³ Efikasiteti – Parimi i efikasitetit nënkupton të marrësh maksimumin nga resurset në dispozicion. ka të bëjë me lidhshmërinë ndërmjet resurseve të angazhuara dhe rezultateve të dhëna në kuptim të sasisë, cilësisë dhe kohës

⁴ Efektiviteti – Parimi i efektivitetit nënkupton arritjen e objektivave të paracaktuara dhe arritjen e rezultateve të pritura.

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme.....	3
1 Hyrje.....	5
Pyetjet dhe kriteret e auditimit	6
2 Përshkrimi i procesit	7
3 Gjetjet e auditimit	9
3.1 A është arritur vlera për para në prokurimet e centralizuara?	9
3.1.1 A janë furnizuar shfrytëzuesit e kontratave në përputhje me nevojat e specifikuara në kontrata të centralizuara?	9
3.1.2 A janë çmimet e produkteve të furnizuara më të lira krahasuar me çmimet në kontrata të pavarura?.....	16
3.1.3 A janë çmimet e produkteve të furnizuara të përafërta me ato të tregut?	21
3.1.4 A ka bërë vlerësim të duhur të përfitimeve dhe kostove nga aktivitetet e centralizuara të prokurimit?	23
3.2 A janë shfrytëzuar si duhet në prokurimet e reja të centralizuara, mësimet e nxjerra nga raporti i auditimit “Vlera për para në prokurimet e centralizuara (pjesa e parë)”?	25
3.2.1 A janë vlerësuar si duhet përfitimet e mundshme nga aktivitetet e reja të centralizuara të prokurimit?	25
3.2.2 A e monitoron AQP-ja si duhet zbatimin e kontratave?.....	31
4 Konkluzionet.....	35
5 Rekomandimet.....	38
Shtojca 1 – Motivi i auditimit, kriteret e auditimit, metodologjia dhe fushëveprimi	40
Fushëveprimi i auditimit.....	41
Qasja e auditimit/Kriteret e Auditimit	41
Metodologjia e auditimit	43
Shtojca 2 Mostra e kontratave të centralizuara.....	44
Shtojca 3 Letër konfirmimi/Komentet e Agjencisë Qendrore të Prokurimit si dhe pikëpamjet e Zyrës Kombëtare të Auditimit	45

Lista e shkurtesave

AK	Autoritet Kontraktues
AQP	Agjencia Qendrore e Prokurimit
ASK	Agjencia Statistikore e Kosovës
ATK	Administrata Tatimore e Kosovës
DK	Dogana e Kosovës
DT	Dosja e Tenderit
KC	Kontrata e centralizuar
KK	Kuvendi i Kosovës
KI	Kontratë individuale
KQZ	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
LPP	Ligji i Prokurimit Publik
MAShT	Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë
MFSK	Ministria e Forcës së Sigurisë
MM	Ministria e Mbrojtjes (ish Ministria e Forcës së Sigurisë)
MPB	Ministria e Punëve të Brendshme
MPMS	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
OB	Organizatë Buxhetore
OE	Operator Ekonomik
PK	Policia e Kosovës
QS	Qendra Studentore
SKGjK	Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës
ShKK	Shërbimi Korrektues i Kosovës
UP	Universiteti i Prishtinës
ZKA	Zyra Kombëtare e Auditimit
ZKM	Zyra e Kryeministrit

Përmbledhje e përgjithshme

Duke filluar prej muajit prill të vitit 2015, Agjencia Qendrore e Prokurimit ka zhvilluar dhjetëra aktivitete të prokurimit që kanë rezultuar me kontrata të centralizuara të cilat janë të obliguara t'i shfrytëzojnë të gjitha organizatat që financohen nga buxheti shtetëror. Fillimisht, Agjencia Qendrore e Prokurimit kishte zhvilluar aktivitete për prokurimin e disa llojeve të mallrave të përbashkëta (karburant, letër, material për zyrë etj.) e me kalimin e kohës e kishte zgjeruar gamën e mallrave që prokuron në emër të organizatave buxhetore, të cilat së bashku shpenzojnë dhjetëra miliona euro çdo vit për t'i blerë këto mallra. Qëllimi i prokurimeve të centralizuara është që të arrihen kursime buxhetore.

Në vitin 2018, Zyra Kombëtare e Auditimit ka publikuar raportin e auditimit të kontratave të para të centralizuara, por në atë kohë ato ishin ende në proces të zbatimit dhe iu kishte mbetur edhe një kohë e konsiderueshme deri në përmbyllje. Duke marrë parasysh këtë, nuk ishte e mundur të arrihej në konkluzionin përfundimtar prandaj Zyra Kombëtare e Auditimit ka kryer auditimin "Vlera për para në prokurimet e centralizuara, pjesa e dytë" i cili është vazhdimësi e auditimit të vitit 2018. Në këtë auditim, kemi audituar tetë kontrata të centralizuara të zbatuara gjatë viteve 2016-2019 dhe katër kontrata të centralizuara që ishin lidhur gjatë viteve 2018-2019 të cilat ishin në zbatim e sipër. Objektivë e këtij auditimi është të vlerësojmë nëse është arritur vlera për para në aktivitetet e centralizuara të prokurimit, gjegjësisht a janë arritur kursime buxhetore, si dhe a ka nxjerrë mësim Agjencia Qendrore e Prokurimit nga përvoja në prokurimet e para të centralizuara.

Ne kemi identifikuar shfrytëzuesit më të mëdhenj të tri kontratave të centralizuara (Policia e Kosovës, Administrata Tatimore e Kosovës, Dogana, Shërbimi Korrektues i Kosovës, etj.) dhe kemi krahasuar shpenzimet e realizuara përmes kontratave të centralizuara me ato të kontratave individuale përkatëse, për një numër të kufizuar të artikujve, që ishin të krahasueshëm.

Konkluzioni i përgjithshëm është se Agjencia Qendrore e Prokurimit përmes aktiviteteve të centralizuara të prokurimit ua kishte kursyer organizatave buxhetore 2.5% të mjeteve të dedikuara për prokurimin e mallrave të caktuara. Kjo për shkak se në përgjithësi çmimet e artikujve të prokuruar përmes kontratave të centralizuara ishin më të ulëta se sa çmimet e artikujve përkatës në kontrata individuale. Rrjedhimisht, shuma totale e kursyer vetëm në tri kontrata të centralizuara, me vlerë të përgjithshme prej 19 milion euro, ishte mbi 477 mijë euro.

Mirëpo, meqë jo të gjithë artikujt në kontrata të centralizuara ishin me çmime më të ulëta se çmimet e artikujve përkatës në kontrata individuale, Agjencia Qendrore e Prokurimit nuk iu kishte siguruar kursime buxhetore disa organizatave buxhetore, përkundrazi iu kishte shkaktuar shpenzime shtesë.

Kjo formë e prokurimit kishte rezultuar me 105 mijë euro shpenzime shtesë për disa organizata buxhetore sepse çmimet e artikujve të caktuar në kontratat e centralizuara ishin më të larta se çmimet e artikujve përkatës në kontrata individuale.

Përveç kursimit prej 477 mijë eurove, Agjencia Qendrore e Prokurimit do të mund të kursente edhe afër 514 mijë euro sikur gjatë përcaktimit të vlerës së parashikuar të kontratës t'iu kishte referuar çmimeve më të ulëta të kontratave individuale. Kështu vlera e parashikuar do të ishte më e ulët se ajo që e kanë përcaktuar dhe do të siguronte çmime më të lira të artikujve përkatës. Me këtë, kursimi total që do të rezultonte nga prokurimet e centralizuara do të arrinte mbi një milion euro që paraqet mbi 5% të buxhetit të shpenzuar në vetëm tri kontrata të centralizuara.

Më tutje, Agjencia Qendrore e Prokurimit kishte mangësi në komunikim me shfrytëzuesit e paraparë të kontratave të centralizuara që për pasojë kishte pasur mbivlerësim ose nënvlerësim të nevojave e cila ishte bërë shkak për realizimin e ulët ose të tepërt të tyre.

Mangësi janë vërejtur edhe në monitorimin e kontratave të centralizuara nga ana e Agjencisë Qendrore të Prokurimit. Mungesa e monitorimit efektiv kishte bërë që Agjencia Qendrore e Prokurimit të mos ndër marr veprime korigjuese kur kontratat nuk ishin duke u zbatuar siç ishin paraparë. Veprimet që i kishte ndërmarrë ishin të vonuara dhe për pasojë s'kishin pasur asnjë efekt korigjues.

Për më tepër, Agjencia Qendrore e Prokurimit nuk kishte bërë një analizë të mirëfilltë të efekteve të prokurimit të centralizuar për të konstatuar se a po rezultojnë me kursime apo me shpenzime shtesë dhe për të marrë vendim a të vazhdohet me prokurim të centralizuar apo jo. Ndër tjera, kjo gjendje ishte shkaktuar nga hulumtimi i mangët i tregut që do t'i siguronte Agjencisë çmime referente me të cilat do të krahasoheshin çmimet e kontratave të centralizuara.

Bazuar në çështjet e identifikuar rezulton se ka nevojë për përmirësime në procesin e prokurimit të centralizuar. Për të eliminuar mangësitë e identifikuar, kërkohen veprime konkrete dhe për këtë kemi dhënë gjashtë rekomandime për Agjencinë Qendrore të Prokurimit si përgjegjëse për zhvillimin e prokurimeve të centralizuara. Lista e rekomandimeve, është paraqitur në Kapitullin 5 të këtij raporti.

Përgjigja e palëve të përfshira në auditim

Ne nuk kemi pranuar përgjigje nga Ministri i Financave, Punës dhe Transfereve ndërsa Agjencia Qendrore e Prokurimit është pajtuar pjesërisht me gjetjet tona. Letër konfirmimin dhe komentet e Agjencisë Qendrore të Prokurimit i gjeni tek Shtojca 3.

1 Hyrje

Një pjesë e konsiderueshme e buxhetit të shtetit shpenzohet përmes aktiviteteve të prokurimit publik. Ligji nr. 04/L-042⁵ për Prokurimin Publik (LPP) bazohet në parimet e ekonomisë, efikasitetit dhe trajtimit të barabartë/jo-diskriminimit.

Sipas nenit 94 të LPP-së, në kuadër të Ministrisë së Financave të Republikës së Kosovës është themeluar Agjencia Qendrore e Prokurimit (AQP), e cila është përgjegjëse për: zhvillimin e prokurimeve të përbashkëta për Autoritete kontraktuese; me kërkesën e Autoriteteve kontraktuese kryen aktivitete të prokurimit në emër të tyre si dhe me kërkesën e Autoriteteve kontraktuese ndihmon në kryerjen e aktiviteteve të prokurimit.

Bazuar në nenet 94-97 të LPP-së dhe në udhëzimet administrative⁶ që i miraton Qeveria, AQP-ja zhvillon aktivitete të centralizuara të prokurimit për mallra, shërbime dhe punë, për të gjitha autoritetet kontraktuese (organizatat buxhetore) të nivelit qendror, lokal, si dhe institucionet e pavarura të Kosovës. Këto aktivitete të prokurimit rezultojnë zakonisht me kontrata/marrëveshje kornizë me afat deri në 36 muaj.

Prej vitit 2015, AQP-ja ka zhvilluar dhjetëra aktivitete të prokurimit që kanë rezultuar me kontrata të centralizuara të cilat i shfrytëzojnë Organizatat Buxhetore (OB-të). Fillimisht, AQP-ja kishte marrë përgjegjësinë për prokurimin e disa llojeve të mallrave të përbashkëta (naftë, letër, material për zyrë etj.) pastaj kishte vazhduar duke e zgjeruar gamën e mallrave që prokuron me aktivitete të centralizuara. Gjatë periudhës 2016-2019, AQP-ja kishte lidhur kontrata me vlerë të përgjithshme rreth 145 milionë euro për mallra/shërbime për përdorim të përbashkët.

Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA) në vitin 2018 ka audituar tetë kontrata të centralizuara dhe ka identifikuar mangësi në procesin e planifikimit dhe monitorimit të këtyre kontratave. Shumica e kontratave të centralizuara ishin në nivel të ulët të realizimit sa që mund të mos e arrinin pragun prej 70% të kontratës, të paraparë me ligj dhe rrjedhimisht mos të arrinin vlerën për para.

Prokurimi i centralizuar, do të duhej të rezultonte me kursim për shkak se pritet që operatorët ekonomik të ofrojnë mallrat e tyre me çmime më të ulëta, gjë që ua mundëson ekonomia e shkallës⁷ (operatorit ekonomik i ulen kostot për njësi të produktit kur ka rritje në vëllimin e shitjes, rrjedhimisht ka hapësirë për ulje të çmimit). Gjithashtu, prokurimi i centralizuar mundëson kursimin e burimeve (njerëzve dhe kohës) sepse i fuzionon dhjetëra aktivitete individuale të prokurimit në një aktivitet të vetëm.

⁵ <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2772>, ndryshuar me ligjet 04/L-237 dhe 05/L-068 dhe 05/L-092

⁶ <https://aqp.rks-gov.net/wp-content/uploads/2019/09/Udhezimi-per-Prokurime-Qendrore-2019-1.pdf>

⁷ Sigma papers No. 47, fq 18, 56 dhe 63 <https://www.oecd-ilibrary.org/docserver/5kgkgqv703xw-en.pdf?expires=1582009296&id=id&accname=guest&checksum=165CA94537699D9B3C40985FBECF1936>

Prokurimi i centralizuar mundëson më shumë transparencë se prokurimet e pavarura. Kjo për shkak se para se AQP-ja të fillojë me prokurimet e centralizuara disa autoritete kontraktuese kishin bërë blerje me vlera minimale (zakonisht material zyrtar) që nuk publikoheshin.

Me rastin e zhvillimit të prokurimit të centralizuar nga palët e përfshira në të, kërkohet që t'i identifikojnë me kujdes dhe sa më saktë nevojat e tyre⁸, t'i komunikojnë ato me kohë⁹ tek AQP-ja dhe ta menaxhojnë¹⁰ pjesën e tyre të kontratës sipas planit të miratuar në mënyrë që të arrihet synimi kryesor i çdo prokurimi (vlera për para). Ndërsa, nga AQP-ja kërkohet që të vendos komunikim efektiv me njësitë kërkuese, të bëjë hulumtim të tregut dhe analiza të kontratave paraprake të OB-ve, të monitorojë vazhdimisht se a po zbatohen kontratat sipas planit¹¹ dhe të marrë veprime korrigjuese sa herë që identifikon devijim nga ai plan¹².

Njësitë kërkuese në bashkëpunim me AQP-në janë përgjegjëse që të ndërmarrin të gjitha veprimet për të arritur vlerën më të mirë për para.

Objektivi dhe pyetjet e auditimit

Objektivi i këtij auditimi është të vlerësojmë se a është arritur vlera për para në aktivitetet e centralizuara të prokurimit. Meqë ky auditim është vazhdimësi e auditimit paraprak, gjithashtu synojmë që të vlerësojmë sa efektive ishin veprimet e AQP-së për të trajtuar rreziqet në fazën e planifikimit për aktivitetet pasuese të prokurimit të centralizuar si dhe rreziqet gjatë monitorimit të realizimit të kontratave.

Pyetjet dhe kriteret e auditimit

Për të arritur objektivin e auditimit, kemi formuluar dy pyetje kryesore, me nën-pyetjet përkatëse, të auditimit. E para i referohet gjendjes në prokurimet e centralizuara që kanë qenë në fushëveprimin e auditimit Vlera për para në prokurimet e centralizuara, pjesa e parë, bazuar në të cilat kemi dhënë rekomandime për AQP-në. Ndërsa, pyetja e dytë ka të bëjë me mësimet që AQP-ja ka nxjerrë nga prokurimet e mëhershme dhe se a i ka aplikuar ato në prokurimet e reja.

1. A është arritur vlera për para në prokurimet e centralizuara?
2. A janë shfrytëzuar si duhet në prokurimet e reja të centralizuara mësimet e nxjerra nga raporti i auditimit Vlera për para në prokurimet e centralizuara (pjesa e parë)?

Për nën-pyetjet dhe kriteret e auditimit shih shtojcën 1.

⁸ Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ Për Prokurimin Publik - Neni 9 Përcaktimi i nevojave që duhet përmbushur

⁹ Ibid, Neni 5.7

¹⁰ Udhëzim Administrativ (QRK) Nr. 05/2016 Për Zbatimin E Procedurave Qendrore Të Prokurimit Publik Neni 6 Pika 4

¹¹ Ibid Neni 4 pika 2-4

¹² Udhëzim Administrativ (QRK) Nr. 03/2017 Për Plotësimin Dhe Ndryshimin E Udhëzimit Administrativ (QRK) Nr. 05/2016 Për Zbatimin E Procedurave Qendrore Të Prokurimit Publik – Neni 4 pika 5

2 Përshkrimi i procesit

Kur AQP-ja merr vendim për zhvillimin e aktiviteteve të centralizuara të prokurimit, bazuar në Udhëzimin Administrativ për prokurimet e centralizuara të lëshuar nga Ministria e Financave, vendos komunikimin formal me të gjitha Organizatat Buxhetore (OB) që do të përfshihen në këto aktivitete për të marrë informatë lidhur me nevojat e secilës prej tyre.

Informatat që i kërkon AQP-ja nga OB-të janë lloji i artikujve për të cilët kanë nevojë si dhe sasia përkatëse për kohëzgjatjen e kontratës (zakonisht tri vite). Për prokurimet që bëhen për herë të parë AQP-ja kërkon edhe çmimin përkatës të artikujve bazuar në kontratat paraprake të OB-ve. Krahas çmimit nga kontratat e OB-ve, AQP-ja duhet të sigurojë edhe çmime nga hulumtimi në treg.

Për t'u siguruar se OB-të kanë dorëzuar informata të sakta, AQP-ja duhet të kërkojë nga to edhe Deklaratën e Nevojave dhe Disponueshmërisë së Mjeteve.

AQP-ja i konsolidon nevojat e të gjitha OB-ve në një dokument të vetëm në të cilin paraqiten të gjitha nevojat, nga lloji dhe sasia, e të gjitha OB-ve që do të përfshihen në kontratë. Kësaj sasia, AQP-ja ia aplikon çmimet që duhet të kenë rezultuar nga hulumtimi i tregut dhe analiza e kontratave paraprake të OB-ve. Kështu AQP-ja e llogaritë vlerën e parashikuar të kontratës së centralizuar e cila paraqitet në njoftim për kontratë ndërsa nevojat e OB-ve në detaje bëhen pjesë e Dosjes së tenderit (DT).

AQP-ja e publikon njoftimin për kontratë me të cilin njoftohen Operatorët Ekonomik (OE) të interesuar për të ofertuar.

OE-të dorëzojnë ofertat e tyre brenda afatit të specifikuar në DT. Ofertat vlerësohen dhe shpallet oferta fituese.

Çmimi i ofertës fituese duhet të jetë më i ulët ose së paku i njëjtë me vlerën e parashikuar të kontratës¹³, përndryshe tenderi do të duhej refuzuar pasi që mund të mos e arrijë vlerën për para¹⁴.

Kur lidhet kontrata, AQP-ja njofton të gjitha OB-të që janë pjesë e kontratës së centralizuar dhe kërkon që secili prej tyre të caktojë një menaxher të kontratës me të cilin do të komunikojë në rast se realizimi i kontratës nuk shkon sipas parashikimit, gjegjësisht sipas nevojave të deklaruara të OB-së. AQP-ja monitoron zbatimin e kontratës sipas kushteve të përcaktuara në të, duke pranuar rregullisht raporte nga OE-të.


¹³ <http://webarchive.nationalarchives.gov.uk/20130802195149/https://www.nao.org.uk/report/getting-value-for-money-from-procurement-how-auditors-can-help/>

¹⁴ http://www.audit-scotland.gov.uk/docs/best_value/2010/bv_100809_procurement_toolkit.pdf


AQP-ja duhet të merr veprime korigjuese në rast se OB-të nuk i shfrytëzojnë sa duhet kontratat përkatësisht i shfrytëzojnë më shumë se që duhet. Kjo në mënyrë që të mos tejkalohet sasia e kontraktuar (tavani prej 130% i vlerës/sasisë së kontraktuar) ose që të arrihet ajo (pragu prej 70%)¹⁵.

Grafiku 1: Zhvillimi i aktivitetit të prokurimit nga ana e AQP-së

Si duhet të jetë:



Si është aktualisht:



¹⁵ Ligji Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092

3 Gjetjet e auditimit

Në këtë kapitull kemi paraqitur gjetjet e auditimit për t'i dhënë përgjigje dy pyetjeve kryesore të auditimit, përkatësisht a është arritur vlera për para në prokurimet e centralizuara? dhe a janë shfrytëzuar si duhet në prokurimet e reja të centralizuara, mësimet e nxjerra nga raporti i auditimit Vlera për para në prokurimet e centralizuara (pjesa e parë)?

Gjetjet i kemi prezantuar sipas pyetjeve, së pari prezantohen gjetjet për të parën gjegjësisht për kontratat të cilat ishin zbatuar e pastaj gjetjet prezantohen për pyetjen e dytë, gjegjësisht për kontratat e reja që ishin lidhur pas zbatimit të kontratave të para.

3.1 A është arritur vlera për para në prokurimet e centralizuara?

Në këtë seksion janë prezantuar gjetjet lidhur me kontratat e para të centralizuara, përkatësisht ato që kishin hyrë në fuqi gjatë viteve 2015-2016 e që ishin zbatuar gjatë tri viteve pasuese. Këto kontrata janë shqyrtuar duke marrë parasysh aspektin e furnizimit sipas kontratës, dallimin mes çmimit të kontraktuar nga AQP-ja dhe çmimit të kontratave individuale si dhe çmimeve të tregut dhe në fund në aspektin e analizës së përfitimit nga prokurimi i centralizuar.

3.1.1 A janë furnizuar shfrytëzuesit e kontratave në përputhje me nevojat e specifikuar në kontrata të centralizuara?

Pas zbatimit të tetë kontratave të para të centralizuara kornizë që ne i kemi audituar, kemi analizuar raportet që AQP-ja i kishte pranuar në baza gjashtë mujore nga furnizuesit përkatës, dhe kemi gjetur se realizimi nuk ishte në përputhje me planifikimin. Vlera e realizuar e kontratave nuk ishte as e përafërt me vlerën e planifikuar. Sipas LPP-së devijimi i lejuar nga sasia e kontraktuar është +/-30% e vlerës/sasisë së kontraktuar.


Tabela 1: Realizimi i kontratave kundrejt planifikimit ('000 euro)

Nr. i prokurimit	Kontrata për:	Vlera e kontraktuar	Vlera e realizuar	Nënshpenzim/ (mbishpenzim)	Përqindja e realizuar
15-001	Karburante	11,571 ¹⁶	16,306	(4,735)	140.9%
16-005	Dru	314	347	(33)	110.5%
15-006	Mazut	2,388	1,893	495	79.3%
15-007	Pelet	549	396	154	72.1%
16-005	Thëngjill	169	102	58	60.7%
15-002	Material zyrtar	2,479	1,526	953	61.6%
15-004	Goma	2,805	1,587	1,217	56.6%
15-002	Letër	4,683	1,259	3,424	26.9%

¹⁶ Për kontratën furnizim me karburante është tejkaluar taveni prej 130%

Prej tetë kontratave që kemi audituar, njëra e kishte tejkaluar me 11% tavanin e lejuar (130%) ndërsa katër prej tyre nuk e kishin arritur pragun prej 70% të vlerës së kontraktuar. Tri kontrata tjera ishin brenda limiteve të lejueshme të devijimit.

Grafiku 2: Realizimi i kontratave kundrejt planifikimit



Ndërkaq, shkak për realizimin e ulët të kontratave ishte mbivlerësimi i nevojave - planifikimi i dobët - nga ana e AQP-së, përkatësisht nga shfrytëzuesit e paraparë të kontratave (OB-ve/njësive kërkuese). AQP-ja i kishte marrë të mirëqena nevojat për mallra që shfrytëzuesit e paraparë të kontratave i kishin deklaruar, kryesisht përmes e-mail-it, pa u siguruar se ato ishin bazuar në ndonjë analizë të të dhënave historike (p.sh. të dhënat nga e-pasuria) dhe pa ia bashkëngjitur edhe deklaratën e nevojave dhe disponueshmërisë së mjeteve që shërben si mjet kontrolli në çdo aktivitet të prokurimit publik. Kësisoj ky mbivlerësim i nevojave kishte sjellë për pasojë realizimin e ulët të kontratave të centralizuara.

Monitorimi i zbatimit të kontratave nga ana e AQP-së nuk kishte parandaluar realizimin e ulët, përkatësisht të lartë, të kontratave. Monitorimi ishte jo-efektiv për shkak se AQP edhe pse kishte marrë nga OE-të raporte gjashtëmujore mbi zbatimin e kontratave, nuk i kishte analizuar fare. Në mungesë të analizës së raporteve AQP-ja s'kishte informacion mbi progresin e kontratave e për pasojë AQP-ja ishte vonuar në ndërmarrjen e veprimeve parandaluese ose korrigjuese.

AQP-ja pothuaj gjatë gjithë kohës së zbatimit të kontratave të centralizuara nuk kishte kontaktuar e as kërkuar llogari nga OB-të që nuk i shfrytëzonin sa duhet kontratat e centralizuara. Vetëm rreth një muaj para përfundimit të afatit të kontratës, AQP-ja kishte kontaktuar disa nga shfrytëzuesit e dy kontratave (furnizim me goma dhe furnizim me material zyrtar) për t'ua tërhequr vëmendjen lidhur me shfrytëzimin e ulët të kontratave, por që atëherë çfarëdo veprimi nga ana e shfrytëzuesve kishte pasur efekt minimal në rritjen e sasisë së realizuar.

Furnizimi me karburant

Shkak për realizimin tepër të lartë të kontratës për furnizim me karburant ishte mungesa e monitorimit efektiv të kontratës nga ana e AQP-së. Bazuar në analizën që ne i kemi bërë raporteve të zbatimit të kontratës, fillimisht kontrata ishte zbatuar me një trend të ngadalshëm për shkak se shumë OB të përfshira në kontratë nuk kishin filluar ta shfrytëzonin atë sepse kontratat e tyre individuale ishin akoma në fuqi. Sipas këtij trendi nuk pritej që kontrata të arrinte as pragun prej 70%. Me skadimin e kontratave individuale, shtoheshin shfrytëzuesit e kontratës, ndërsa realizimi i afrohej vëllimit të kontraktuar të karburantit.

Tabela 2: Furnizimi me karburant për 36 muaj sipas kontratës 15-001

Tremujori	Sasia e furnizuar kumulative '000 litra	% kumulative e realizimit
TM 1-16	129	1.1%
TM 2-16	390	3.4%
TM 3-16	669	5.8%
TM 4-16	1,755	15.2%
TM 1-17	2,254	19.5%
TM 2-17	2,645	22.9%
TM 3-17	3,794	32.9%
TM 4-17	6,532	56.6%
TM 1-18	9,467	82.0%
TM 2-18	10,890	94.4%
TM 3-18	12,246	106.1%
TM 4-18	15,186	131.6%
Janar 2019	16,348	141.7%

Për 28 muaj shfrytëzuesit e kontratës ishin furnizuar me gjithsej 10,890,293 litra që paraqiste mbi 94% të sasisë së kontraktuar. Ndërsa gjatë tetë muajve vijues, që kishin mbetur deri në skadim të kontratës, shfrytëzuesit e kontratës ishin furnizuar edhe me mbi 5.4 milion litra karburant që në total e çonte furnizimin në mbi 16.3 milion litra. Fillimisht ishte paraparë të furnizoheshin me rreth 11.5 milion litra karburant, me çka realizimi kishte arritur nivelin 141% që e kishte tejkaluar tavanin e lejuar me 11%

Nga analiza e raportit të furnizimit me karburant, të cilin AQP-ja e pranon nga OE-ja, kemi gjetur se disa shfrytëzues të kontratës ishin furnizuar përtej nevojave që kishin deklaruar, një rast deri mbi gjashtëfishin e sasisë së deklaruar.

Tabela 3: Sasia e furnizuar mbi atë të deklaruar për disa nga shfrytëzuesit e kontratës

Emri i Autoritetit Kontraktues	Sasia e deklaruar /36 muaj	Furnizimi	Mbi furnizimi	Mbi furnizimi %
Policia e Kosovës	3,218,000	5,418,260	2,200,260	168%
Shërbimi Korrektues i Kosovës	643,500	1,855,518	1,212,018	288%
Qendra Studentore	107,000	737,472	630,472	689%
Ministria e Punëve të Brendshme	505,000	1,073,817	568,817	213%
Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit	156,000	343,261	187,261	220%
Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë	341,000	527,090	186,090	155%
Ministria e Administratës Publike	202,000	358,540	156,540	177%
Komuna Istog	104,000	236,539	132,539	227%
Ministria e Drejtësisë	41,500	172,136	130,636	415%
Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural	103,000	209,351	106,351	203%

Tabela tregon se Policia e Kosovës (PK) kishte deklaruar se kishte nevojë për 3,218,000 litra karburant ndërsa ishte furnizuar me 5,418,260 litra, pra 2,200,260 litra ose 68% më shumë. Pastaj vjen Shërbimi Korrektues i Kosovës (ShKK) që kishte kërkuar 643,500 litra, ishte furnizuar me 1,855,518 litra pra e kishte tejkaluar sasinë e kërkuar me 1,212,018 litra ose 188% më shumë, e kështu me radhë.

Në anën tjetër kishte edhe OB të përfshira në kontratë që nuk ishin furnizuar fare me karburant edhe pse kishin kërkuar një gjë të tillë.

Tabela 4: OB-të që nuk e kanë shfrytëzuar kontratën fare

Emri i Autoritetit Kontraktues	Sasia e kontraktuar 36 muaj	Furnizimi	Nën furnizimi
Paneli Zgjedhor i Shqyrtimit të Ankesave dhe Parashtrësave	2,800	-	2,800
Qendra Universitare e Klinikës Stomatologjike të Kosovës	3,000	-	3,000
Sekretariati i Këshillit të Sigurimit të Kosovës	8,000	-	8,000
Instituti Albanologjik	13,000	-	13,000
Universiteti i Prishtinës	39,200	-	39,200
Universiteti i Pejës	92,000	-	92,000
Universiteti i Prizrenit	122,000	-	122,000
Universiteti i Mitrovicës	145,000	-	145,000
Trepça nën administrimin e AKP	305,000	-	305,000
Akademia e Kosovës për Sigurinë Publike	350,000	-	350,000
Gjithsej	1,080,000	-	1,080,000

Tabela tregon se asnjë nga këto OB nuk kishin shfrytëzuar asnjëherë kontratën e centralizuar edhe pse ishin pjesë e saj. AQP nuk i kishte kontaktuar asnjëherë asnjërin prej tyre për t'u interesuar

lidhur me mbi furnizimin përkatësisht nën furnizimin me karburant. Mirëpo ne kemi kontaktuar pesë OB-të e fundit në tabelë dhe kemi gjetur se të gjitha, përveç Trepçës, e kishin shfrytëzuar kontratën e centralizuar. Kjo do të thotë se shifrat e raportuara nga OE nuk janë të sakta dhe se shifra prej 16.3 milion litrash mund të jetë edhe më e lartë, përkatësisht përqindja e tejkalimit të tavanit mund të jetë më e lartë se 11%.

Në mungesë të monitorimit efektiv nga ana e AQP-së kishte ardhur deri te tejkalimi i sasisë së kontraktuar, që përveç që paraqet shkelje të LPP-së, kishte bërë që AQP-ja të nis me vonesë edhe aktivitetin e ri të prokurimit për karburant. Në mungesë të monitorimit efektiv, AQP-ja s'kishte informatë se sasi të kontraktuara ishin realizuar rreth tetë muaj para afatit të paraparë të skadimit të kontratës dhe për pasojë nuk e kishte nisur aktivitetin tjetër të prokurimit me kohë. Aktiviteti tjetër i prokurimit për furnizim me karburant ishte nisur me 9/11/18 ndërkaq furnizimi në atë kohë gati kishte arritur nivelin 130% si dhe kontratës i skadonte afati pas tre muajve (11/2/2019).

Furnizimi me letër

Për kontratën furnizim me letër nevojat ishin mbivlerësuar pesëfish. Vlera e kontraktuar ishte afër 4.7 milion euro për tri vite ndërsa realizimi gjatë këtyre tri viteve kishte arritur në vetëm afër 1.3 milion euro ose 27% të vlerës së kontraktuar. Shkak për këtë mbivlerësim ishte një gabim teknik që AQP-ja e kishte bërë gjatë llogaritjes dhe agregimit të nevojave individuale të shfrytëzuesve të paraparë të kontratës si pasojë kishte ardhur deri te realizimi i ulët. Nevojat e deklaruara për letër të të gjitha llojeve ishin 363,829 njësi ndërsa për shkak të gabimit ishin kontraktuar 1,798,181 njësi AQP nuk ishte në dijeni për këtë gabim, kjo është vërejtur nga auditorët gjatë auditimit të kësaj kontrate.

Tabela 5: Sasi të letrës të llogaritura gabimisht

Nr	Artikulli	Nevojat e deklaruara nga 79 OB	Shumëzuar (gabimisht) me 5
1	Letër universale për kopje A4/80 g/m2	322,270	1,611,350
2	Letër universale për kopje A4/100 g/m2	16,704	83,520
3	Letër universale për kopje A3/80 g/m2	10,430	52,150
4	Letër speciale për zyre A4/160 g/m2	6,185	30,925
5	Letër speciale për zyre 250 gr/m2	2,999	14,995
6	Letër mbështjellës për plotter A0	1,266	1,266
7	Letër mbështjellës për plotter A1	1,030	1,030
8	Letër Flipchart	2,945	2,945
	Gjithsej	363,829	1,798,181

Shfrytëzuesit e paraparë të kontratës i kishin deklaruar AQP-së se për çfarë sasi të letrës kanë nevojë mirëpo AQP-ja e kishte pesëfishuar (gabimisht për shkak se një pako me letër përmban 5 risë, pakoja është ngatërruar me rrishtë prandaj është shumëzuar me 5) sasinë e deklaruar dhe si të tillë e kishte publikuar në Dosje të tenderit e më pastaj e kishte kontraktuar po atë sasi.

Mbivlerësimi do të kishte mundur të parandalohej sikur AQP të kishte konfirmuar nevojat sasiore kundrejt potencialit përkatës buxhetor të shfrytëzuesve të paraparë të kontratës. AQP-ja nuk kishte kërkuar që shfrytëzuesit t'i konfirmojnë nevojat e tyre me **deklaratë të nevojave dhe disponueshmërisë së mjeteve**. Ky dokument shërben si mjet kontrolli në çdo prokurim publik pavarësisht vlerës së kontratës (edhe për ato nën 1,000 euro), ndërsa nuk është përdorur në këtë prokurim të centralizuar ku vlera e kontratës arrin në miliona euro.

Sikur të parandalohej gabimi, çmimi i kësaj kontrate do të ishte rreth 950 mijë euro (në vend të 4,7 milion euro) dhe do të realizohej 132% (1,259,123 euro/952,634 euro).

Një numër i konsiderueshëm i shfrytëzuesve të paraparë të kontratës, gjithsej 31 prej 79 shfrytëzuesve, nuk kishin bërë asnjë porosi për letër, ndërkaq kërkesa e përgjithshme e tyre për llojet e ndryshme të letrës përbënte afër 13% të sasisë së përgjithshme të kërkuar/kontraktuar. Shkak për këtë mos-veprim të këtyre njësisve kërkuese ishte se AQP-ja nuk e kishte specifikuar në kontratë sasinë e letrës të kontraktuar për secilin shfrytëzues, në mënyrë që çdonjëri prej tyre të merr përgjegjësinë për t'u furnizuar në pajtim me të.

Për pasojë realizimi i kësaj kontrate e kishte arritur këtë nivel i cili, pavarësisht se nuk kishte pasur pasoja financiare për AQP-në apo për shfrytëzuesit e kontratës, mund të bëhet shkak që AQP të perceptohet si AK jo serioze, e për pasojë paraqet rrezik që, si kontraktuesi aktual ashtu edhe ofertuesit potencial të humbin interesimin për të ofertuar në prokurime të centralizuara që do të thotë se mund të ketë më pak konkurrencë në prokurimet e centralizuara.

Furnizimi me material zyrtar

Nevojat për furnizim me material zyrtar ishin mbivlerësuar gjithashtu. Nga gjithsej 197 artikuj të përfshirë në kontratë vetëm 13 prej tyre ishin realizuar brenda kufijve të lejuar të devijimit (+/-30%), shtatë prej tyre ishin realizuar mbi 130% ndërsa pjesa më e madhe e artikujve (177 artikuj) nuk e kishin arritur pragun prej 70%. Kjo për pasojë kishte realizim të ulët të kontratës që gjithashtu nuk e kishte arritur pragun e paraparë me ligj. Në total kontrata ishte realizuar vetëm afër 62%.

Furnizimi me goma

Mbivlerësimi i nevojave ishte bërë shkak që kontrata **furnizim me goma** të realizohej vetëm afër 57%. Planifikimi i dobët nga ana e shfrytëzuesve të kontratës ishte shkak që AQP të kontraktoj më shumë se që ishte e nevojshme dhe për pasojë vetëm pak më shumë se gjysma e vlerës së kontratës ishte realizuar.

Nga krahasimi i nevojave që kishin deklaruar shfrytëzuesit e kontratës me raportin mbi zbatimin e kontratës kemi gjetur se sasi të e kërkuara kishin dallim të madh me sasi të e realizuara.

Tabela 6: Realizimi kundrejt kërkesës për kontratën për furnizim me goma (njësi)

Shfrytëzuesi i kontratës	Sasia e kërkuar	Sasia e realizuar	Ndryshimi
Policia e Kosovës	9,144	7,728	-1,416
Ministria e Mbrojtjes (ish MFSK)	4,672	3,443	-1,229
Dogana e Kosovës	656	782	126
Ministria e Punëve të Brendshme	360	495	135
Administrata Tatimore e Kosovës	752	591	-161

Shfrytëzuesit e kontratës, sidomos ata që kishin kërkuar sasi të mëdha, ishin furnizuar më pak se që kishin kërkuar, p.sh. Policia kishte deklaruar se kishte nevojë për 9,144 goma ndërsa ishte furnizuar me 7,728 njësi që paraqet afër 85% të sasisë së deklaruar.

Ngjashëm edhe Ministria e Mbrojtjes (ish Ministria e Forcës së Sigurisë) nga 4,672 goma për të cilat kishte deklaruar se ka nevojë, ishte furnizuar me 3,443 njësi që paraqet afër 74% të sasisë së deklaruar.

Faktor kontribuues që kishte shkaktuar mospërputhje mes sasisë së realizuar dhe asaj të kontraktuar të gomave ishte edhe paftësia e OE-së për t'i furnizuar shfrytëzuesit e kontratës sipas kërkesës së tyre. Kemi gjetur dy raste të tilla, njëri në Polici ku OE kishte dështuar të dorëzojë gjithsej 150 goma sipas kërkesës së Policisë dhe rasti tjetër në Ministri të Mbrojtjes ku OE kishte dështuar të dorëzojë gjithsej 214 goma që kishte kërkuar Ministria. Të dy këta shfrytëzues kishin raportuar çështjen në AQP, Policia pasi që kishte aplikuar gjobën e paraparë me kontratë ndaj OE-së kurse Ministria ishte këshilluar nga AQP-ja që gjithashtu të aplikojë gjobë.

Furnizimi me thëngjill

Mbivlerësimi i nevojave ishte bërë shkak që kjo kontratë të mos realizohet siç ishte kontraktuar. Kjo kontratë e centralizuar kishte vetëm dy shfrytëzues – Komunën e Drenasit dhe Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale, e cila kishte deklaruar 120 ton (vetëm një lloj të thëngjillit), derisa Komuna e Drenasit kishte deklaruar se kishte nevojë për tri lloje të thëngjillit dhe se do të blinte gjithsej 3,600 tonë gjatë tri viteve të parapara të zbatimit të kontratës. Vlera totale e kontratës ishte 168,660 euro ndërsa Komuna e Drenasit kishte shpenzuar për thëngjill vetëm 102,451 euro, ndërsa Ministria nuk kishte bërë porosi fare. Me këtë, kontrata ishte realizuar afër 61% të vlerës së kontraktuar duke mos e arritur pragun prej 70% të vlerës së kontraktuar.

Çështja e kontratave me pak shfrytëzues është identifikuar edhe në auditimin paraprak dhe AQP-ja mes tjerash është rekomanduar që të azhurnoj listën e artikujve të përdorimit të përbashkët dhe të përfshijë në të vetëm artikujt për të cilët kanë nevojë më shumë shfrytëzues.

Kontratat tjera

Sa i përket tri kontratave tjera të centralizuara – furnizim me dru, furnizim me pelet dhe furnizim me mazut - shfrytëzuesit ishin furnizuar brenda kufijve të lejuar dhe nuk janë raportuar probleme as nga ana e OE-së e as nga ana e shfrytëzuesve. Në pajtim me rekomandimin e dhënë në raportin

paraparak të auditimit të performancës të vitit 2018, AQP-ja e kishte ndërprerë aktivitetin e prokurimit të centralizuar për këto kontrata, përfshi edhe kontratën për furnizim me dru, pasi që kishin vlerë relativisht të vogël dhe numër të vogël të shfrytëzuesve. Megjithatë, AQP-ja kishte vazhduar të zhvillojë aktivitet të centralizuar për kontratën për furnizim me mazut meqë vlera e saj ishte e madhe.

Sa i përket kontratave që nuk ishin realizuar ashtu siç ishte pritur, efekti më i keq i mundshëm – padi nga ana e OE-ve për mos realizim të kontratës - megjithatë ishte shmangur. Duke e parë rrezikun që e kemi raportuar në raportin e vitit 2018, AQP-ja kishte kontaktuar dy nga katër OE-të, kontratat e të cilëve nuk ishin në nivelin e duhur të realizimit dhe kishte kërkuar të deklarohen se *“janë pajtuar që nuk ka obligime në mes të palëve siç parashihet në Kushtet e përgjithshme të kontratës, në nenin 1.3 dhe 1.4.”*. Me këtë AQP, dhe të gjithë shfrytëzuesit e kontratës, ishin liruar nga ndonjë kërkesë për kompensim që do të mund të vinte nga OE-të ose ndonjë gjobë/dëmshpërblim i mundshëm si rezultat i padisë eventuale.

Duke i marrë për të mirëqena deklaratat e nevojave të OB-ve, AQP-ja nuk kishte verifikuar se a janë me të vërtetë këto nevoja reale? Në mungesë të këtij verifikimi nevojat e deklaruara vetëm ishin konsoliduar ashtu siç ishin deklaruar dhe si të tilla ishin bërë pjesë e dosjes së tenderit, për t’u bërë më vonë pjesë e kontratës. Për pasojë katër nga tetë kontratat që ne kemi audituar kishin arritur afatin e skadimit pa u realizuar siç ishin planifikuar.

3.1.2 A janë çmimet e produkteve të furnizuara më të lira krahasuar me çmimet në kontrata të pavarura?

Çmimet e produkteve të furnizuara me kontratë të centralizuar duhet të jenë më të lira krahasuar me çmimet e kontratave individuale dhe me çmimet e tregut për shkak të ekonomisë së shkallës (operatorit ekonomik i ulet kostoja për njësi të produktit kur i rritet vëllimi i shitjes, rrjedhimisht ka hapësirë për ulje të çmimit).

Me kontratën furnizim me karburant ishin kontraktuar rreth 11.5 milion litra ndërsa shfrytëzuesit e kësaj kontrate ishin furnizuar me mbi 16.3 milion litra, me çmim të premiumit 0.055 euro për litër të karburantit si dhe çmimi për transport për litër ishte 0.0167 që do të thotë se për çdo litër të naftës shfrytëzuesit e kontratës kishin paguar 0.0717 euro, përveç çmimit sipas bursës dhe kostove tjera si dogana, tatimi në vlerën e shtuar etj. Shfrytëzuesit më të mëdhenj të kësaj kontrate ishin Policia, pasuar nga ShKK-ja dhe MPB-ja.

Tabela 7: Shfrytëzuesit më të mëdhenj të kontratës furnizim me karburant

Shfrytëzuesi	2016	2017	2018	2019	Gjithsej	%
PK		1,649,699	3,384,545	384,017	5,418,260	33%
ShKK		424,470	1,206,384	224,664	1,855,518	11%
MPB	308,292	345,170	388,781	31,574	1,073,817	7%
QS	340,993	278,855	89,863	27,761	737,472	5%
KGjK		152,768	427,364	92,029	672,161	4%
MPMS	167,963	228,670	229,384	39,425	665,442	4%
MASHT	293,540	131,257	49,460	52,833	527,090	3%
Tjerat (63 shfrytëzues)	644,689	1,565,549	2,878,128	309,894	5,398,260	33%
Gjithsej					16,348,020	100%

Siç e tregon tabela, PK kishte shpenzuar 33% të sasisë së përgjithshme, pasuar nga ShKK që merrte 11% të furnizimit të përgjithshëm dhe të tjerët me radhë. Këta shfrytëzues në kontratat e tyre individuale ishin furnizuar me çmim të premiumit si vijon:

Tabela 8: Krahasimi i çmimit të kontratës së centralizuar me kontratat e individuale

Shfrytëzuesi	Premiumi për litër	Transporti për litër	Gjithsej çmimi	Ndryshimi krahasuar me çmimin e AQP	Sasia e realizuar	Kursimi
PK	0.0940	0.0167	0.1107	-0.0390	5,418,260	211,312
ShKK	0.0550	0.0167	0.0717	0.0000	1,855,518	-
MPB	0.0940	0.0167	0.1107	-0.0390	1,073,817	41,879
QS	0.0400	0.0333	0.0733	-0.0016	737,472	1,180
KGjK	0.0760	0.0167	0.0927	-0.0210	672,161	14,115
MPMS	0.0900	0.0168	0.1068	-0.0351	665,442	23,357
MASHT	0.1000	0.0167	0.1167	-0.0450	527,090	23,719
Gjithsej					10,949,760	315,562

Në këtë tabelë paraqitet ndryshimi mes çmimit të kontratës së centralizuar dhe çmimit të kontratave individuale për naftë (dizel) për automjete. Përveç çmimit të premiumit, që ishte i ndryshëm në këto OB, në kontratat për furnizim me karburant, si në atë të centralizuar ashtu edhe në ato individuale, ishte përfshirë edhe çmimi i transportit të karburantit, i cili gjithashtu ishte i ndryshëm në secilën OB. Edhe kontrata e centralizuar i kishte po këto dy çmime mirëpo shuma e të dyjave ishte më e ulët se sa shuma përkatëse e OB-ve me kontratë individuale. Prandaj kontrata e centralizuar për furnizim me karburant, krahasuar me kontratat individuale, ishte më ekonomike. Kështu duke shfrytëzuar këtë kontratë, MPB-ja dhe Policia kanë kursyer së bashku afër 235,191 euro, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS) ka kursyer 23,357 euro, euro ndërsa ShKK-ja as nuk ka kursyer as nuk ka humbur meqë çmimi i saj ishte i njëjtë me atë të AQP-së. Të gjithë këta shfrytëzues së bashku kishin kursyer gjithsej 315,562 euro duke qenë pjesë e kontratës së centralizuar. Kjo shumë përfaqëson afër 3% e vlerës së shpenzimit që kemi analizuar.

Mirëpo, sikur kjo kontratë e centralizuar (AQP 15-001) të kishte çmimin e kontratës paraprake (AQP 13-001) të AQP-së për furnizim me karburant, kursimi i lartcekur do të ishte edhe më i lartë për shkak se çmimi i premiumit ishte 0,026 euro për litër ose 0.029 euro më i ulët. Kjo do të thotë se përveç 315 mijë eurove, AQP-ja do të kishte kursyer edhe afër 318 mijë euro tjera.

Përveç kësaj, nëse krahasohet me kontratën e centralizuar pasuese të kësaj kontrate, kursimi do të ishte edhe më i lartë për shkak se çmimi i premiumit të kontratës pasuese ishte vetëm 0.01 euro për litër dhe koston së karburantit nuk i ngarkohet më as çmimi i transportit.

Në përgjithësi, krahasuar me prokurimet për furnizim me karburant, që shfrytëzuesit e kontratës së centralizuar i kishin bërë në mënyrë të pavarur, prokurimi i AQP-së rezulton të jetë më ekonomik.

Kontratën e centralizuar për furnizim me letër e kemi krahasuar me kontratat individuale (në të kaluarën të lidhura nga vet OB-të pa ndërmjetësimin e AQP-së) dhe kemi gjetur se kishte dallime në mes të çmimeve që i kishin arritur OB-të në mënyrë individuale dhe atyre që i kishte arritur AQP.

Tabela 9: Shfrytëzuesit më të mëdhenj të kontratës për furnizim me letër

Shfrytëzuesi	Letër A/4 80gr Sasia	Pjesëmarrja në KC	Çmimi në kontratat individuale	Çmimi i KC	Kursimi / Shpenzimi shtesë nga Kontrata e AQP
PK	95,531	19.0%	2.26	2.38	11,464
SKGjK	70,714	14.1%	2.23	2.38	10,607
ATK	69,000	13.8%	2.35	2.38	2,070
MPB	38,926	7.8%	2.45	2.38	-2,725
UP	31,797	6.3%	2.38	2.38	0
ZKM	24,350	4.9%	2.30	2.38	1,948
ShKK	17,670	3.5%	2.28	2.38	1,767
KK	17,500	3.5%	3.40	2.38	-17,850
MPMS	16,324	3.3%	2.40	2.38	-326
MAShT	11,012	2.2%	2.95	2.38	-6,277
Tjerat	108,820	21.7%			
Gjithsej furnizimi	501,644	100.0%			
Gjithsej kursimi					678

Krahasimi i kontratës së AQP-së për furnizim me letër ka nxjerrë në pah se AQP kishte kontraktuar çmime më të larta se sa ato që i kishte arritur PK-ja, Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës (SKGjK) dhe Administrata Tatimore e Kosovës (ATK), që janë tre shfrytëzuesit më të mëdhenj të kontratës. Përveç këtyre janë edhe Zyra e Kryeministrit (ZKM) dhe ShKK-ja që kanë pasur çmime më të lira në kontratat e tyre individuale. Këta pesë shfrytëzues ishin furnizuar me mbi 55% të sasisë totale të letërës A4 të kësaj kontrate dhe të pesëve së bashku kontrata e centralizuar iu kishte kushtuar 27,856 euro më shtrenjtë.

Megjithatë çmimi prej 2.38 euro për rriskë të letrës A4 që e kishte kontraktuar AQP-ja ishte më i lirë për 1.02 euro krahasuar me çmimin që e kishte kontraktuar Kuvendi i Kosovës (KK) me kontratë individuale. Ky ndryshim për rriskë i kishte sjellë KK-së kursim prej 17,850 euro, pastaj Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë 6,277 euro (ndryshimi 0.57 euro për rriskë) si dhe MPB-së 2,725 euro (ndryshimi 0.08 euro për rriskë). Sipas kësaj analize kursimi për këta shfrytëzues arrin vlerën 27,187 euro. Mirëpo, kur kësaj shume i hiqet kostoja shtesë që iu kishte shkaktuar disa shfrytëzuesve tjerë të kontratës së centralizuar, kursimi amortizohet dhe mbetet vetëm 678 euro.

Edhe pse shfrytëzuesit më të mëdhenj kishin arritur që individualisht të kontraktojnë çmime më të lira se AQP-ja me kontratë të centralizuar, d.m.th. u janë shkaktuar kosto shtesë, kur bashkohen me shfrytëzuesit tjerë të kontratës së centralizuar, kontratat individuale të së cilëve kanë pasur çmime më të larta, rezulton që aktiviteti i centralizuar i prokurimit ishte efektiv për shkak të këtij rezultati të pranueshëm. Megjithatë, duke pasur parasysh se vëllimi i KC-së është shumë herë më i lartë se sa vëllimi i cilësdo kontratë individuale, çmimi i kontraktuar nga AQP-ja nuk është aq ekonomik, që do të thotë se AQP-ja nuk kishte arritur potencialin maksimal të kursimit.

Gjithsej kursimi potencial që do të arrihej nëse AQP-ja do të kishte kontraktuar çmimin e letrës sipas çmimit më të ulët nga kontratat individuale do të arrinte shumën prej 75,247 euro (501,644 x 0.15 euro; sasia e rriskave të blera të letrës A4 shumëzuar me ndryshimin mes çmimit të kontratës së centralizuar me çmimin e kontratës individuale të SKGjK-së).

Disa artikuj që janë blerë më shpesh me kontratë të centralizuar për **furnizim me material zyrtar** i kemi krahasuar me çmimet përkatëse të disa kontratave individuale (në të kaluarën të lidhura nga vet OB-të pa ndërmjetësimin e AQP-së) dhe kemi gjetur se kishte dallime në mes të çmimeve që i kishin arritur OB-të dhe atyre që i kishte arritur AQP-ja.

Tabela 10: Artikujt e kontratës furnizim me material zyrtar që më së shumti janë blerë, sipas vlerës

Artikulli	Përshkrimi	Sasia e porositur	Shuma e paguar	Çmimi KC	Çmimi ATK	Çmimi UP	Ndryshimi	Shpenzimi shtesë
16	Dosje e fajllit (folder), me ngjyra, me kuti. 80mm	87,794	162,404	1.85	1.19	1.3	0.55 deri 0.66	48,286 deri 57,944
33	Fasiklla transparente me vrima A/4 1/100	59,967	118,735	1.98	1.30		0.68	40,778
6	Zarf nga letra me mbyllje LC4	4,286	41,771	9.8		5	4.80	20,573
14	Dosje me shirita me ngjyra, kapaciteti 150 fletë	14,294	23,841	1.78	0.23		1.55	22,156
80	Vetë ngjitës, notes me ngjyrë për postim 76*76 mm	59,212	20,724	0.35	0.18		0.17	10,066
	Gjithsej							151,516

Edhe pse kontrata e AQP-së për furnizim me material zyrtar kishte numër të madh të artikujve që ishte vështirë t'ua gjeje emërtimin e njëjtë në kontratë individuale, bazuar në përshkrimet e tyre kemi gjetur disa nga artikujt e mësipërm të cilët ishin blerë me çmime më të ulëta se me kontratë të centralizuar. Ky krahasim i pesë artikujve më të shpeshtë, që përbënte afër 39% të shpenzimit të realizuar të kontratës së centralizuar, ka nxjerrë në pah se për këta artikuj AQP-ja kishte kontraktuar çmime më të larta se sa ato që i kishin arritur disa shfrytëzues më parë me kontrata individuale. Në artikujt e cekur në tabelë do të mund kurseheshin afër 152,000 euro sikur AQP-ja të kishte arritur të siguronte çmime të njëjta me ato të kontratave individuale. Në mungesë të analizës së kontratave paraprake individuale AQP-ja kishte pranuar çmime ashtu siç kishin ofertuar OE-të dhe për pasojë kontrata kishte prodhuar këtë efekt, kosto shtesë për shfrytëzuesit e saj, pra nuk e ka arritur potencialin e plotë të kursimit.

Meqë AQP-ja nuk kishte bërë një studim të kontratave paraprake si pjesë e hulumtimit të tregut, nuk kishte identifikuar çmimet e arritshme në treg për pasojë për disa artikuj kishte kontraktuar çmime më të larta se ato që i kishin kontraktuar OB-të individualisht.

Efekti i prokurimit të centralizuar është i panjohur përderisa nuk ka analizë krahasuese të çmimeve të kontratave të centralizuara me ato individuale të shfrytëzuesve të përfshirë në KC.

Krahasimi i kontratës së centralizuar për furnizim me goma ka nxjerrë në pah se AQP-ja kishte kontraktuar çmime më të larta se sa ato që i kishte arritur Ministria e Mbrojtjes, që është shfrytëzuesi më i madh i kontratës për furnizim me goma, pas Policisë së Kosovës. Ministria kishte shpenzuar mbi 466 mijë euro me këtë kontratë për të blerë mbi 4,300 goma të llojeve të ndryshme. Ne kemi krahasuar çmimet e 33 llojeve të gomave me të cilat ishte furnizuar Ministria për të cilat kishte shpenzuar afër 434 mijë euro. Ministria do të shpenzonte vetëm 357 mijë euro, gjegjësisht do të kursente afër 77 mijë euro nëse këto goma do t'i kishte blerë me çmimet e kontratave të cilat i kishte lidhur vet, para se kontrata e AQP-së të hynte në fuqi. Pra kontrata e AQP-së ishte më e shtrenjtë për afër 18% në krahasim me kontratën e Ministrisë.

Tabela 11: Krahasimi i çmimit të gomave mes kontratës individuale të MFSK dhe kontratës së centralizuar

Lloji i gomës	Çmimi i MM	Çmimi AQP	Sasia e blerë	Kosto shtesë
365/80R20	416.5	799.2	78	29,849
315/80R22.	231	302.4	150	10,710
195/70R15C	61.31	62.05	562	434
10R22.5 16	181.3	208	163	4,093

Në këtë tabelë kemi paraqitur vetëm disa lloje të gomave të cilat Ministrisë së Mbrojtjes (ish Ministria e Forcës së Sigurisë së Kosovës) i kishin kushtuar më shtrenjtë me kontratë të centralizuar. Për shembull gomën 365/80R20, Ministria e kishte blerë me çmim 416.5 euro me kontratë individuale ndërsa me kontratë të centralizuar kjo gomë i kishte kushtuar 799 euro. Ministria i kishte blerë gjithsej 78 goma të tilla duke iu shkaktuar kosto shtesë prej 29,850 euro $[(78 * 799) - (78 * 416.5)]$.

Megjithatë, kur kontrata e AQP-së krahasohet me kontratën e Policisë rezulton një kursim prej afër 237 mijë eurove. Me kontratë të centralizuar, furnizimi me goma, Policisë i kishte kushtuar rreth 452 mijë euro (10 llojet më të zakonshme) ndërsa furnizimi me të njëjtat goma me kontratë individuale, Policisë do t'i kishte kushtuar 689 mijë euro. Pra kontrata e AQP-së ia kishte ulur shpenzimet e Policisë, për furnizim me goma, për 34%.

Po ashtu, kontrata e centralizuar ia kishte ulur shpenzimet për goma edhe Doganës së Kosovës (DK). Nga 14 llojet e gomave me të cilat ishte furnizuar Dogana me kontratë të centralizuar, ne kemi gjetur gjashtë lloje të gomave që ishin të krahasueshme me kontratat individuale të saj. Dogana kishte blerë 476 goma të këtyre gjashtë llojeve të cilat i kishin kushtuar 25,338 euro, ndërsa po ato goma Doganës do t'i kishin kushtuar 22,865 euro sikur t'i kishte blerë me kontratë individuale, që do të thotë se kontrata e centralizuar ia kishte kursyer 2,473 euro ose rreth 10% të buxhetit për këto goma.

Edhe pse kishte arritur kursime me kontratë të centralizuar, AQP-ja nuk kishte identifikuar ose nuk i kishte marrë për bazë kontratat paraprake për të parashikuar çmimet e mundshme/pranueshme për këtë kontratë prandaj i kishte dhënë kontratën ofertuesit të përgjegjshëm që kishte ofertuar çmimet më të ulëta, pavarësisht se këto çmime ishin më të larta se çmimet e mundshme, p.sh. më të larta se çmimet e kontratës individuale të Ministrisë së Mbrojtjes.

Mungesa e studimit të kontratave paraprake si pjesë e hulumtimit të tregut ishte bërë shkak që AQP-ja të përcaktojë një vlerë të parashikuar të kontratës e cila kishte mundësuar lidhjen e kontratës që përmbante çmime më të larta se ato të kontratave paraprake.

Me kontratën e centralizuar për furnizim me goma AQP-ja kishte arritur t'ia kursejë 237 mijë euro PK-së dhe 2,473 euro DK-së, ndërsa Ministrisë i kishte shkaktuar kosto shtesë për rreth 77 mijë euro sepse çmimet e gomave bazuar në kontratë të centralizuar ishin më shtrenjta krahasuar me kontratë individuale të Ministrisë. Synimi i AQP-së për prokurim ekonomik ishte arritur pjesërisht për shkak se çmimet e kontratës së centralizuar ishin jo gjithë herë më të ulëta se çmimet e kontratave individuale.

3.1.3 A janë çmimet e produkteve të furnizuara të përafërta me ato të tregut?

Çmimet e furnizuara me kontratë të centralizuar duhet të jenë më të lira krahasuar me çmimet e tregut për shkak të ekonomisë së shkallës (operatorit ekonomik i ulet kostoja për njësi e produktit kur i rritet vëllimi i shitjes, rrjedhimisht ka hapësirë për ulje të çmimit).

Kontratat e lidhura nga AQP-ja i kemi krahasuar me çmimet e tregut me pakicë të cilat i kemi konstatuar nga çmimet që i publikon Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) si dhe nga fatura që ishin lëshuar për blerës privat gjatë kohës që kontrata e AQP-së ishte në fuqi.

Çmimi mesatar me pakicë për 1 litër të karburantit (naftë), i publikuar nga ASK-ja, gjatë viteve 2016-2019 ishte si në vijim:

Tabela 12: Krahasimi i çmimit të tregut me çmimin e KC për furnizim për karburant

Viti	2016	2017	2018
Çmimi mesatar për litër të naftës sipas ASK	0.93	1.02	1.12
Çmimi mesatar për litër të naftës sipas KC të AQP	0.85	0.99	1.10
Ndryshimi €	0.08	0.03	0.02
Ndryshimi %	9%	3%	2%

Në tabelën e mësipërme shohim se çmimi që kishte arritur AQP ishte më i ulët se çmimi mesatar i tregut i konstatuar nga ASK-ja, megjithatë ky ndryshim për çdo vit ishte reduktuar dukshëm, nga 9% sa ishte në vitin e parë të zbatimit të kontratës së centralizuar në vetëm 2% në vitin e fundit. Megjithatë çmimi i AQP-së ishte i bazuar në bursë dhe çmimi i premiumit nuk kishte pasur lëvizje gjatë viteve të zbatimit të kontratës.

Shfrytëzuesit e kontratës së centralizuar për furnizim me goma më së shumti kishin blerë gomën e llojit 195/65R15, gjithsej 2,509 copë, pasuar me llojin 235/65R17 me 1,807 copë.

Ne kemi siguruar çmimin e tregut me pakicë për gomat verore të llojit 195/65R15 dhe 205/55R16 dhe i kemi krahasuar me çmimet e kontratës së centralizuar.

Tabela 13: Çmimet e gomave në treg krahasuar me çmimet e KC-së

Artikulli	Sasia e furnizuar	Çmimi i tregut	Çmimi i KC-së	Ndryshimi në €	Ndryshimi %	Kursimi/Kosto shtesë
195/65R15	1,150	39.0	38.25	0.75	4.49%	862
205/55R16	617	45	45.90	-0.90	2.0%	-555
175/65R14	208	33.15	32.3	0.85	2.50%	177
185/65R15	96	40.95	36.5	4.45	10.7%	427
Gjithsej						911

Goma verore e llojit 195/65R15 në treg me pakicë shitej me 39 euro ndërsa AQP-ja i kishte kontraktuar me 38.25 euro. Shfrytëzuesit e kontratës së centralizuar i kishin blerë gjithsej 2,509 goma prej të cilave 1,150 goma verore që do të thotë se ndryshimi prej 0.75 euro për njësi nënkupton kursim prej rreth 862 euro për shfrytëzuesit e kontratës. Po ashtu, AQP-ja kishte arritur kursim prej 604 euro edhe për dy llojet tjera të gomave që në total arrijnë kursim prej 1,466 euro.

Mirëpo, shfrytëzuesit e KC-së i kishin blerë 1,263 njësi të llojit të gomave 205/55R16, prej të cilave 617 goma dimërore, që AQP-ja i kishte kontraktuar me 45.90 euro, ndërsa në tregun me pakicë ishin shitur për 45 euro për njësi. Në këtë rast, AQP-ja kishte shpenzuar shfrytëzuesve të kontratës për çdo gomë nga 0.90 euro më shumë krahasuar me çmimin e tregut ose mbi 2% më shtrenjtë për secilën nga 617 gomat e blera, që gjithsej arrin shumën 555 euro. Që do të thotë se kursimi neto për këto katër lloje të gomave ishte 911 euro (1,466 euro -555 euro).

Për kontratat e tjera të centralizuara nuk kemi mundur të sigurojmë çmime të tregut përkatëse me kohën kur KC-të kanë qenë në zbatim, prandaj nuk kemi mundur të bëjmë krahasime.

Edhe pse kryesisht çmimet e KC-së ishin më të ulëta se çmimet e tregut, kishte edhe raste kur çmimet e tregut ishin më të ulëta se çmimet e kontratës së centralizuar. Këto ndryshime nuk ishin vërejtur para se të niseshin aktivitetet e prokurimit për shkak se AQP-ja nuk kishte bërë hulumtim adekuat të tregut. Për pasojë, AQP-ja kishte nisur aktivitetin e prokurimit pa objektivë të qartë, pa caqe të deklaruar të kursimit dhe nuk e kishte realizuar plotësisht potencialin e saj për çmime ekonomike.

3.1.4 A ka bërë vlerësim të duhur të përfitimeve dhe kostove nga aktivitetet e centralizuara të prokurimit?

Pas zbatimit të kontratave, AQP-ja duhet të bëjë analiza për të vlerësuar përfitimet dhe kostot e shkaktuara nga aktivitetet e centralizuara të prokurimit në raport me prokurimet individuale. Këtë AQP-ja duhet ta bëjë për çdo vit, duke hartuar raportin vjetor të punës dhe raporte tjera analitike që i publikon në ueb-faqen e saj.

Të gjitha kontratat që AQP i kishte lidhur në vitin 2016 ishin zbatuar. AQP-ja nuk kishte bërë analizë gjithëpërfshirëse të zbatimit të tyre (të paktën jo të dokumentuar) për të konstatuar se sa ishin kursimet ose shpenzimet shtesë të shkaktuara nga prokurimi i centralizuar.

Një analizë e AQP-së e paraqitur në raportin vjetor të saj thekson se kursime janë arritur në secilin aktivitet të prokurimit që ajo kishte zhvilluar. Këtë e kishte bazuar në vlerën e parashikuar të kontratave të centralizuara, të cilin e kishte llogaritur duke i mbledhur të gjitha vlerat e parashikuara të secilit shfrytëzues të kontratës dhe duke e krahasuar atë me vlerën e kontraktuar të kontratës së centralizuar. Meqë vlera e kontraktuar ishte gjithnjë më e ulët se vlera e parashikuar, AQP-ja kishte konstatuar se kishte kursim aq sa është diferenca mes këtyre dy vlerave.

Vërejtja jonë në këtë metodologji është se ndryshimi mes vlerës së parashikuar dhe vlerës së kontraktuar nuk është tregues real i kursimit për shkak se edhe në prokurimet individuale në shumicën e rasteve, vlera e parashikuar është më e lartë se vlera e kontraktuar. Për më tepër, AQP-ja nuk e kishte konfirmuar vlerën e parashikuar nga secili shfrytëzues i kontratës për dy arsye: për shkak se jo secili shfrytëzues i kontratës iu kishte përgjigjur dhe për shkak se edhe përgjigjet që i kishte marrë nuk ishin të konfirmuara si duhet sepse iu mungonte nënshkrimi i personave që janë të autorizuar me ligj për të konfirmuar Zyrtari kryesor financiar dhe Zyrtari kryesor administrativ. Prandaj, vlera e parashikuar e siguruar nga shfrytëzuesit e kontratave mund të jetë mbivlerësuar siç ishte rasti me Policinë që kishte deklaruar vlerë të parashikuar për furnizim me goma 1.2 milion euro përderisa kishte shpenzuar vetëm rreth 450 mijë euro.

Për kontratat e zbatuara, kemi kërkuar të mësojmë nga AQP-ja se a ka realizuar kursime, siç ka qenë edhe synimi i saj, dhe nëse po sa kanë qenë kursimet për disa nga shfrytëzuesit më të mëdhenj të këtyre kontratave, nëse e ka konstatuar cilët janë shfrytëzuesit më të mëdhenj.

Ne kemi kërkuar të dhënat në vijim për kontratat:

1. Furnizimi me karburante;
2. Furnizimi me letër; dhe
3. Furnizimi me goma.

Në vijim janë, pyetjet e parashtruara tek AQP-ja lidhur me kontratat e cekura më lartë:

- Cilët janë 10 shfrytëzuesit më të mëdhenj të kontratës në aspektin e vlerës?
- Cilët janë 10 shfrytëzuesit më të mëdhenj të kontratës në aspektin sasior?
- Cilët janë 10 artikujt më të shpeshtë që i kanë blerë këta 10 shfrytëzues?
- Sa ishte diferenca mes çmimeve të këtyre 10 artikujve krahasuar me çmimet në kontratat individuale të këtyre 10 shfrytëzuesve? dhe
- Sa është kursimi/shpenzimi shtesë i shkaktuar nga prokurimi i centralizuar për secilin nga këta 10 shfrytëzues të kontratës?

AQP-ja ishte në gjendje të hartoj një raport në përgjigje të kërkesave tona por që raportit i mungonte konkluzioni i qartë dhe i prerë lidhur me kursimet, përkatësisht kostot shtesë të shkaktuara nga prokurimi i centralizuar, për shkak se i mungonin çmimet referente për krahasim, përkatësisht iu mungonin kontratat individuale të shfrytëzuesve të KC-së. Analiza të tilla ishin të vështira për AQP-në edhe për shkak se AQP-ja nuk kishte një sistem për menaxhimin e informacionit lidhur me zbatimin e kontratave. Me qëllim të monitorimit, AQP-ja kishte hartuar formularë në formatin Excel, të cilët kontraktuesit (OE-të) e kishin përgjegjësi t'i plotësonin dhe dërgonin tek AQP-ja. Mirëpo, formularët si të tillë, përmbajnë mundësi të madhe për regjistrime të gabuara, e për pasojë edhe të dhënat që nxirren nga raportet e tilla mund të mos jenë të plota dhe të sakta. Në këto raporte (p.sh. furnizimi me material zyrtar dhe furnizimi me goma) kemi gjetur se kontraktuesi e kishte regjistruar artikullin e njëjtë me çmime të ndryshme. Gabim tjetër që kemi gjetur në këta formularë është se shfrytëzuesit e kontratës ishin regjistruar me emra të ndryshëm, pastaj edhe nën-njësitë organizative të shfrytëzuesve të kontratës paraqiteshin në raport që e kishte komplikuar edhe më tepër monitorimin e zbatimit të kontratës. Prandaj plotësia dhe saktësia e artikujve të furnizuar për secilin shfrytëzues ishte çështje që vështirësonte analizën e AQP-së, ndërsa edhe dizajni i raportit nuk jepte të dhëna të mjaftueshme për të ardhur deri tek informatat që i shërbejnë analizës. P.sh. raporti i kontraktuesit për furnizim me thëngjill përmbante vetëm vlerën e faturuar ndërsa s'kishte asnjë të dhënë për llojin apo çmimin përkatës të thëngjillit që ishte furnizuar, pavarësisht se kishte tri lloje dhe tri çmime të ndryshme të thëngjillit.

Shkaktar për mungesën e rezultateve të besueshme të zbatimit të KC-ve ishte mos përdorimi i një metode të duhur të analizës së prokurimit të centralizuar nga ana e AQP-së. Në mungesë të këtyre informatave AQP-ja kishte përsëritur aktivitetet e prokurimit të sapo përfunduara pa ditur nëse ia vlen të vazhdohet me prokurim të centralizuar apo jo.

AQP-ja nuk ka informatë se a e ka arritur synimin e saj për prokurim ekonomik, rrjedhimisht as Ministria e Financave dhe as shfrytëzuesit e KC-ve (përveç nëse ata i kanë bërë analizat vet, sikur rasti i MM që e kishe bërë analizën për goma dhe kishte konstatuar se në shumicën e rasteve çmimet e kontratës individuale të saj ishin më të ulëta se çmimet e KC-së).

3.2 A janë shfrytëzuar si duhet në prokurimet e reja të centralizuara, mësimet e nxjerra nga raporti i auditimit “Vlera për para në prokurimet e centralizuara (pjesa e parë)”?

Në këtë pjesë prezantohen mësimet që AQP ka nxjerrë ose që do të duhej të kishte nxjerrë nga zbatimi i kontratave të para të centralizuara. Këtu trajtohen veprimet që AQP-ja i kishte ndërmarrë gjatë zbatimit të aktiviteteve të reja të prokurimit të centralizuar.

3.2.1 A janë vlerësuar si duhet përfitimet e mundshme nga aktivitetet e reja të centralizuara të prokurimit?

AQP-ja, si autoritet kontraktues, duhet të dokumentojë në mënyrë të duhur nevojat për blerje, duke vendosur komunikimin me OB-të që përfshihen në kontrata të centralizuara. Të dhënat që i merr nga to lidhur me llojin dhe sasinë e mallrave, gjegjësisht vlerën e parashikuar të tyre, duhet t'i konfirmojë duke siguruar Deklaratën e nevojave dhe disponueshmërisë së mjeteve me të cilën zyrtari kryesor administrativ dhe zyrtari kryesor financiar i OB-së përkatëse konfirmon edhe një herë se OB-ja ka nevojë për llojin dhe sasinë përkatëse të mallrave dhe se ka buxhetuar fonde të mjaftueshme për to.

Gjithashtu, AQP-ja duhet të bëjë hulumtim të tregut duke bërë analizë të kontratave paraprake për furnizim me mallra të njëjta ose të ngjashme, krahas me këtë duhet të bëjë hulumtim në terren (nëse është e mundshme) për t'u siguruar që çmimi i kontraktuar nuk është më i lartë se çmimi i tregut.

Për të parë se a i kishte ndërmarrë AQP-ja këto veprime, ne kemi përzgjedhur katër aktivitete të prokurimit në vijim, tri prej të cilave ishin prokurime të reja që AQP-ja nuk i kishte zhvilluar më parë. Ato janë:

1. Shfrytëzimi afatgjatë i automjeteve me qira;
2. Shërbime të fotokopjimit për nivelin lokal;
3. Furnizim me mish dhe produkte të mishit; dhe
4. Furnizimi me karburante.

Gjetjet për secilën prej këtyre aktiviteteve të prokurimit janë si vijon:

Për kontratën e centralizuar **“Shfrytëzimi afatgjatë i automjeteve me qira”** AQP-ja kishte vendosur komunikim me shfrytëzuesit e paraparë të kontratës për shfrytëzim të automjeteve me qira për t’i identifikuar nevojat për automjete, por edhe pse ua kishte kërkuar Deklaratën e nevojave dhe disponueshmërisë së fondeve, jo të gjithë shfrytëzuesit e kishin dërguar një të tillë. AQP-ja kishte kërkuar që shfrytëzuesit t’i konfirmojnë sasinë e deklaruara fillimisht përmes postës elektronike, ato që nuk i kishin konfirmuar AQP-ja i kishte marrë të mirëqena.

Mirëpo, më vonë njëri nga shfrytëzuesit e paraparë kishte kërkuar që të tërhiqet nga aktiviteti për shkak se nuk kishte buxhetuar mjete për këtë qëllim. Ky rast ka të bëjë me kërkesën e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) për 10 vetura me qira, të cilën, AQP-ja e kishte përfshirë në dosje të tenderit të aktivitetit të prokurimit në fjalë. Kur e kishte kuptuar se KQZ-së i mungonin mjetet për periudhën e paraparë të kohëzgjatjes së kontratës, tanimë ishin përfunduar të gjithë hapat e procesit të prokurimit. AQP-së nuk i kishte mbetur tjetër pos nënshkrimit të kontratës me OE-në që komisioni vlerësues i ofertave e kishte propozuar për fitues të kontratës. Sikur AQP-ja të kishte kërkuar deklaratën e nevojave nga KQZ-ja do të kishte kuptuar, para se të niste aktivitetin e prokurimit, se KQZ-së i mungojnë mjetet për realizimin e kërkesës së saj për 10 automjete. Kjo do t’i lejonte AQP-së që të hartonte dosje të tenderit që reflekton nevojat reale të shfrytëzuesve të paraparë të kontratës dhe që rrjedhimisht mundëson realizimin e saj brenda kushteve të specifikuar në të.

Në Dosje të Tenderit, AQP-ja kishte përfshirë OB si më poshtë:

Tabela 14: OB-të shfrytëzuese të kontratës – automjete të llojit limuzinë

Nr.	Emri i shfrytëzuesit të paraparë	Numri i paraparë i automjeteve	Numri i automjeteve në shfrytëzim
1	Kuvendi i Republikës së Kosovës	10	0
2	Zyra e Presidentit	10	10
3	Ministria e Diasporës	1	0
4	Ministria e Integritimit Evropian	4	0
5	Qendra e Studenteve	1	1
6	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve	10	0
7	Komuna Prishtinës	2	1
8	Komuna Lipjan	1	0
	Gjithsej	39	12

Nga tabela vërejmë se nga 39 automjetet e kontraktuara për shfrytëzim nga tetë shfrytëzuesit e paraparë fillimisht në kontratë, vetëm 12 automjete janë aktualisht duke u shfrytëzuar. Pjesa tjetër e automjeteve, nga shfrytëzimi i të cilave kanë heqë dorë, janë ri-destinuar për shfrytëzues tjerë.

Tabela 15: Shfrytëzuesit aktual të kontratës

Nr.	Emri i shfrytëzuesit	Numri i automjeteve në shfrytëzim
1.	Zyra e Presidentit	10
2.	Zyra e Kryeministrit	7
3.	Prokuroria e Shtetit	6
4.	Agjencia Kosovare e Privatizimit	3
5.	Komuna e Deçanit	2
6.	Këshilli Gjyqësor i Kosovës	2
7.	Ministria e Zhvillimit Rajonal	1
8.	Komuna e Prishtinës	1
9.	Ministria e Tregtisë dhe Industrisë	1
10.	Qendra e Studenteve	1
11.	Autoriteti Kosovar i Konkurrencës	1
12.	Komuna e Gjakovës	1
13.	Ministria e Infrastrukturës	1
14.	Komuna e Vushtrrisë	1
15.	Ministria e Financave	1
	Gjithsej	39

Shkak kryesor për këtë gjendje ishte mungesa e komunikimit adekuat mes AQP-së dhe shfrytëzuesve potencial të kontratës. Faktor tjetër kontribuues i kësaj gjendjeje ishte planifikimi jo i duhur nga ana e shfrytëzuesve të cilët, nuk i kishin planifikuar si duhet nevojat afatgjata dhe si kishin harmonizuar me kapacitete e tyre financiare (me buxhetin e tyre). Mirëpo OB-të tjera që nuk kishin deklaruar nevojat e tyre me kohë, kishin bërë kërkesa të vonshme ad-hock, pas nënshkrimit të kontratës, kishin marrë në shfrytëzim automjetet për të cilat shfrytëzuesit aktual nuk kishin më nevojë.

Për pasojë kishte ardhur deri bartja e automjeteve nga njëri shfrytëzues – që nuk kishte ndarë fonde të mjaftueshme - tek shfrytëzuesi tjetër – që nuk kishte bërë kërkesën në kohën e duhur. Kjo mënyrë e veprimit rrezikon të rezultojë me fatura të papaguara, që më vonë së bashku me gjobë për vonesë mund të paguhen përmes përmbaruesit, ose mund të rezultojë me shpenzime për automjete që nuk shfrytëzohen.

Komunikimi mes AQP-së dhe OB-ve/njësive kërkuese të përfshira në kontratën “**Shfrytëzimi i fotokopjeve dhe printerëve me qira - niveli lokal**”, nuk kishte ndodhur fare. AQP-ja nuk kishte kërkuar të dijë se cilat janë nevojat e përafërta (numrin e përafërt të faqeve të printuara/fotokopjuara), e as nuk kishte kërkuar deklaratat e nevojave dhe disponueshmërisë së mjeteve për të ditur se sa kanë buxhetuar secila nga 13 OB-të e përfshira në kontratë.

Numri i përafërt i printimeve/fotokopjimeve/skenimeve të nevojshme për kontratën e centralizuar, sipas AQP-së, ishte bazuar në kontratën e centralizuar për furnizim me letër¹⁷, gjegjësisht në sasinë e letrës A4 që ishte kontraktuar për secilin shfrytëzues të përfshirë në këtë kontratë. Bazuar në këtë supozim, AQP-ja kishte arritur të bëjë një vlerësim të drejtë të nevojave mirëpo supozimi nuk ishte i saktë sepse katër nga 13 shfrytëzues kishin kontrata individuale që ende ishin në fuqi. AQP-ja nuk i kishte kontaktuar fare shfrytëzuesit e paraparë të kontratës prandaj nevojat e tyre për këtë shërbim ishin mbi vlerësuar dhe për pasojë tre nga këto OB të përfshira në kontratë nuk kishin filluar ta shfrytëzojnë atë edhe pas 19 muajve nga fillimi i saj, ndërsa i katërti kishte filluar të shfrytëzojë atë kontratë pas tetë muajsh dhe gradualisht i kishte instaluar pajisjet përgjatë 10 muajve në vijim. Për pasojë gjatë 19 muajve të parë të zbatimit të kontratës për shfrytëzim të fotokopjeve dhe printerëve me qira, realizimi kishte arritur në vetëm 9% d.m.th për 55 muajt e ardhshëm mbetet të realizohet mbi 90% e vlerës së kontraktuar.

Sa i përket hulumtimit të tregut, AQP-ja nuk i kishte kërkuar kontratat paraprake të këtyre shfrytëzuesve përmes të cilave do të bëhej një krahasim i çmimit të tyre me çmimin potencial të KC-së. AQP-ja nuk kishte as informatë se cilët shfrytëzues të përfshirë në kontratë kishin kontrata në fuqi për këtë shërbim ose për furnizim me toner dhe mirëmbajtje të pajisjeve fotokopjuese. Për pasojë, mungon një analizë e shpenzimeve të secilit shfrytëzues të përfshirë në kontratë për të konstatuar paraprakisht kursimin potencial veç e veç. Rrjedhimisht, për aktivitetin e prokurimit në fjalë, AQP nuk kishte bërë vlerësim adekuat të kostove në raport me përfitimet e pritshme.

Çmimi që AQP-ja kishte parashikuar për këtë tender ishte 0.009 euro për një njësi kopje/printim ndërsa çmimi i ofertës fituese ishte 0.0055 euro ose për 39% më i ulët se çmimi i parashikuar. Edhe çmimet e dy ofertave tjera që ishin dorëzuar për këtë tender silleshin rreth këtij çmimi, përkatësisht e dyta ishte 0.0058 euro për njësi ndërsa e treta 0.0068 euro për njësi. Nga kjo vërehet se vet përcaktimi i vlerës së parashikuar nuk është bërë duke u bazuar në hulumtim të mirëfilltë të tregut apo çmimeve, qoftë nga kontratat e mëparshme të centralizuara apo ato individuale.

AQP-ja nuk kishte ndërmarrë ndonjë hap konkret në drejtim të hulumtimit të tregut, konkluzionet e cilit hulumtim do të shpërfaqnin çmimet e tregut. Nuk i kishte kontaktuar shfrytëzuesit e paraparë të kontratës për të kërkuar kontratat e tyre paraprake në mënyrë që të konstatojë çmimet e arritshme e të pranueshme për këtë kontratë.

Megjithatë, ne kemi gjetur se katër nga shfrytëzuesit aktual (shih tabelën 16) të kontratës së centralizuar, para se të përfshiheshin në kontratën e centralizuar kishin pasur KI të ngjashme me KC po me çmim më të lartë se çmimi i KC-së.

¹⁷ Kontrata AQP-17-003-111

Tabela 16: Çmimet e kontratave individuale për katër shfrytëzuesit e kontratës së centralizuar

Shfrytëzuesi	Çmimi për kopje mbi limit	Qiraja mujore për pajisje dhe numri i kopjeve pa pagesë i përfshirë në këtë shumë
Komuna Obiliq	0.01 euro	20 euro (2,500 kopje)
Komuna Fushë Kosovë	0.007 euro	29 euro (5,000 kopje)
Komuna Drenas	0.007 euro (pa limit)	0
Komuna Lipjan	0.01 €	27.34 euro (15,000 kopje)
Kontrata e centralizuar	0.0055 euro	0

Me kontratë individuale, komuna e Obiliqit kishte obligim të paguante 20 euro qira mujore për një pajisje – këtu përfshiheshin 2,500 kopje pa pagesë – dhe për çdo kopje shtesë duhej paguar edhe 0.01 euro përveç 20 eurove. Kjo do të thotë se tri nga katër komunat në tabelë kishin shpenzime fikse mujore pavarësisht se a i shfrytëzonin pajisjet apo jo, ndërsa me kontratë të centralizuar shfrytëzuesit e kontratës nuk kanë shpenzime fikse por paguajnë vetëm aq sa i shfrytëzojnë pajisjet.

P.sh. nëse komuna e Obiliqit i bën 2,500 kopje paguan 13,75 euro që i bie 6.25 euro më lirë, krahasuar me KI bazuar në të cilën, për këtë numër të kopjeve, kishte paguar 20 euro. Vetëm komuna e Drenasit e kishte dizajnuar kontratën individuale në mënyrë të njëjtë sikurse AQP-ja, megjithatë çmimi i saj ishte për 27% më i lartë se çmimi i AQP-së.

Komuna e Lipjanit kishte kontratë individuale me çmim më të ulët se çmimi i kontratës së centralizuar për faktin se me pagesën e qirasë kishte paguar edhe 15,000 kopje që do të thotë se çmimi për një kopje është 0,0018 euro ose përbën vetëm 33% të çmimit të KC-së. Mirëpo shuma fikse e kontraktuar duhet të paguhet pavarësisht se a i bën ato kopje apo jo. Kështu, nga fatura që komuna e Lipjanit e kishte marrë për muajin qershor 2020 kemi gjetur se në asnjërën pajisje fotokopjuese nuk i kishte bërë më shumë se 5,000 kopje që do të thotë se faktikisht për një kopje kishte paguar çmimin prej 0.0055 që është i njëjtë me çmimin e KC-së.

Ne kemi gjetur se jo të gjithë shfrytëzuesit e paraparë të kontratës së centralizuar kishin filluar ta shfrytëzojnë atë menjëherë pas hyrjes së saj në fuqi (prill 2019). Komuna e Lipjanit kishte kontratë në fuqi për marrje me qira të makinave të fotokopjimit/printimit afati i së cilës skadon në qershor të vitit 2021, ose 25 muaj pas hyrjes në fuqi të kontratës së centralizuar. Komuna e Podujevës ende nuk kishte filluar ta shfrytëzojë kontratën e centralizuar meqë kishte kontratë në fuqi për mirëmbajtje të makinave fotokopjuese që ishin në pronësi të komunës. Kjo komunë synon ta shfrytëzojë kontratën e saj individuale deri në skadim të afatit të saj në shkurt të vitit 2021. Gjithashtu edhe komuna e Drenasit kishte kontratë të tillë që ishte valide deri në qershor 2020 ose 14 muaj pas hyrjes në fuqi të kontratës së centralizuar. Për pasojë kontrata e centralizuar është duke u shfrytëzuar me ritëm të ngadaltë dhe rrezikon të mos arrijë pragun e paraparë prej 70% të sasisë së kontraktuar.

Shkaktar për këtë gjendje ishte mos komunikimi i duhur mes AQP-së dhe shfrytëzuesve të paraparë të kontratës si dhe mbështetja në të dhëna në të cilat nuk do të duhej mbështetur pa u konfirmuar përmes konsultimeve me shfrytëzuesit ose analizave të zbatimit të kontratave.

Komunikimi jo adekuat mes AQP-së dhe shfrytëzuesve të paraparë të KC, mes tjerash, ka bërë që disa shfrytëzues të KC të fillojnë shfrytëzimin e saj shumë më vonë (25 muaj) nga nënshkrimi i KC meqë kishin kontrata të ngjashme kornizë në fuqi për mirëmbajtje të pajisjeve dhe furnizim me toner, e që si rezultat i kësaj KC mund të mbetet e perealizuar.

Për kontratën **“Furnizim me mish, llot 1”**, AQP-ja kishte vendosur komunikim me shfrytëzuesit e paraparë për t’u përfshirë në këtë kontratë të centralizuar, kishte kërkuar dhe siguruar informata lidhur me llojin dhe sasinë e mallrave të nevojshme për secilin prej tyre. Mirëpo, me përjashtim të dy Deklaratave të nevojave dhe të disponueshmërisë së mjeteve, AQP-ja nuk i kishte siguruar ato nga tri shfrytëzuesit tjerë të kontratës, edhe pse i kishte kërkuar. Pavarësisht kësaj, i kishte përfshirë në KC pa arritur të konfirmojë nevojat e deklaruara të shfrytëzuesve të kontratës dhe pa konfirmuar a kanë buxhetuar mjete të mjaftueshme për këtë prokurim.

Edhe pse AQP-ja po e zhvillonte për herë të parë prokurimin e centralizuar për furnizim me mish, nuk kishte bërë hulumtim adekuat të tregut, nuk i kishte marrë kontratat paraprake të shfrytëzuesve të paraparë të kontratës për të identifikuar çmimet e arritshme dhe të pranueshme për këtë prokurim. AQP-së i mungonte një vlerësim paraprak lidhur me përfitimet e pritura nga prokurimi i centralizuar në fjalë.

Ne kemi krahasuar çmimet e katër artikujve të KC-së për furnizim me mish me çmimet e artikujve të njëjtë në kontratë individuale të Shërbimit Korrektues të Kosovës-së¹⁸ që aktualisht është një nga shfrytëzuesit më të mëdhenj të KC-së dhe kemi gjetur se për mish gjedhi, artikullin që merr pjesën më të madhe të shpenzimit, AQP-ja kishte kontraktuar çmim më të shtrenjtë.

Tabela 17: Krahasimi i çmimeve të kontratës së Shërbimit Korrektues të Kosovës me çmimet e kontratës së AQP-së

Artikulli	Njësia	Sasia e kontraktuar nga AQP-ja	Sasia e kontraktuar për ShKK-në	Çmimi AQP-së	Çmimi ShKK-së	Ndryshimi në çmim	Kosto shtesë për ShKK-në
1	2	3	4	5	6	7=5-6	8=3*7
Mish gjedhi	kg	536,460	175,269	5.55	4.85	0.70	131,452

Nga tabela shihet se AQP për 536,460 kg mish kishte kontraktuar çmimin 5.55 euro/kg për dallim prej ShKK-së e cila për 18,000 kg, kishte arritur ta siguroj këtë artikull me çmim 4.85 euro/kg. Çmimi i kontratës së centralizuar është për 15% më i shtrenjtë se çmimi i kontratës individuale të ShKK-së.

¹⁸ Kontrata 21500-15-035-125

Nëse KC realizohet plotësisht, d.m.th nëse blihet e tërë sasia e kontraktuar për ShKK-në do të ketë kosto shtesë prej 131,452 euro.

Megjithatë sipas raporteve të ASK çmimi i konsumit për mish gjedhi kishte pasur ngritje prej 0,7 euro për kg në vitin 2019, kur ishte lidhur kontrata e AQP-së, krahasuar me vitin 2015 kur ishte lidhur kontrata individuale e ShKK-së. Megjithatë kjo ngritje nuk ishte dokumentuar nga AQP në kohën e zhvillimit të aktivitetit të prokurimit të centralizuar, për ta arsyetuar çmimin më të lartë që e kishte pranuar për këtë artikull.

Mirëpo disa çmime të KC-së ishin më të ulëta krahasuar me çmimet e KI-së së ShKK-së që do të thotë se duke shfrytëzuar KC-në për ShKK-në do të ketë kursime.

Tabela 18: Artikujt ku AQP-ja ka siguruar çmim më të volitshëm se Shërbimi Korrektues i Kosovës

Artikulli	Njësi	Sasia e kontraktuar nga AQP-ja	Sasia e kontraktuar për ShKK-në	Çmimi AQP-së	Çmimi ShKK-së	Ndryshimi në çmim	Kursimi për ShKK-në
1	2	3	4	5	6	7=5-6	8=3*7
Suxhuk shtëpiak	kg	68,085	38,580	1.8	2.5	0.7	27,006
Përshutë prej mishi të demit	kg	46,191	32,385	4	5	1	32,385
Pleskavicë 100 GR	kg	22,680	22,440	2.8	3	0.2	4,488
							63,879

Kursimi potencial për këta tre artikuj me të cilët furnizohet ShKK-ja përmes KC-së, mund të arrij 63,879 euro. Ky kursim e amortizon koston shtesë që çmimi më i lartë për mish gjedhi i KC-së i ka shkaktuar ShKK-së duke e reduktuar në 67,573 euro. Kjo shumë përbën mbi 1% të vlerës totale të KC-së.

Përveç këtij kursimi, përmes KC-së do të mund të kurseheshin deri në 402,345 euro sikur AQP-ja, për mish gjedhi, të kishte kontraktuar çmim të njëjtë me çmimin e kontraktuar nga ShKK-ja që paraqet rreth 5% të vlerës së KC-së. Kjo për shkak se ky artikull përbën 54% të shpenzimit të paraparë me KC.

Mos hulumtimi adekuat i tregut ka bërë që AQP, përkundër sasive dukshëm më të mëdha që përmban kontrata e centralizuar, të mos arrij të kontrakttoj çmim më të volitshëm se çmimet e përfituara me KI, të paktën për artikujt që janë paraparë të blihen më së shumti dhe që marrin pjesën më të madhe të shpenzimit.

3.2.2 A e monitoron AQP-ja si duhet zbatimin e kontratave?

AQP-ja duhet të monitorojë progresin e kontratave duke siguruar rregullisht raporte mbi zbatimin e tyre, dhe sipas nevojës, në rast se zbatimi nuk shkon sipas kushteve të kontratës, duhet të kontaktojë menaxherët përkatës të kontratave për të marrë veprime korrigjuese.

Që nga fillimi i zbatimit të KC për **shfrytëzimin e automjeteve me qira**, AQP-ja ka bërë monitorimin e saj aktivisht duke u përfshirë në korigjimin e menaxhimit të dobët të saj nga ana e shfrytëzuesve të kontratës. Meqë nuk kishte mundur të parandalojë planifikimin e dobët në fazën e tenderimit të kësaj kontrate, AQP-ja ishte detyruar të veprojë si ndërmjetësuese për të mundësuar bartjen e automjeteve nga njëri shfrytëzues tek tjetri. Shkaqet për mos shfrytëzimin e automjeteve me qira, sipas AQP-së, ishin të ndryshme duke filluar nga ndryshimet strukturore nëpër organizata tek shfrytëzuesit e kontratës e deri te fondet e pamjaftueshme për këtë KC.

AQP-ja kishte pranuar raporte nga OE-ja por edhe ato nuk ishin dizajnuar mirë sepse përmbanin vetëm të dhëna se cili shfrytëzues i posedonte automjetet e kontraktuara e asgjë lidhur me kilometrat e kaluara të automjeteve, për servisimet apo riparimet e automjeteve. Në mungesë të këtij informacioni, së bashku me mungesën e analizës kosto-përfitime që është dashur të bëhet para se të merret vendimi për centralizimin e këtij prokurimi, është e pamundur të konstatohet se a është arritur vlera për para në këtë prokurim.

P.sh. Zyra e Presidentit të Kosovës kishte kërkuar dhe kishte marrë 10 automjete me qira. Gjithsej kilometrat e kaluara për 31 muaj ishin 601,433 km, ndërsa kishte paguar qira në vlerë prej 149,388 që i bie për çdo kilometër të kaluar kishte paguar mesatarisht 0.25 euro.

Tabela 19: Automjetet e marra me qira nga Zyra e Presidentit

Data e fillimit të kontratës	Kilometrat e kaluara	Shpenzimet e qirasë deri me 31-10-2020 (31 muaj)	Shpenzimet për km
28-03-18	26,178	14,939	0.57
28-03-18	32,323	14,939	0.46
28-03-18	54,025	14,939	0.28
28-03-18	54,164	14,939	0.28
28-03-18	60,143	14,939	0.25
28-03-18	68,491	14,939	0.22
28-03-18	70,107	14,939	0.21
28-03-18	73,245	14,939	0.20
28-03-18	76,967	14,939	0.19
28-03-18	85,790	14,939	0.17
	601,433	149,388	0.25

Siç shihet në tabelën nr.19, kilometrat e kaluara sillen prej rreth 26,000 deri në afër 86,000 kilometra për automjet për 31 muaj që do të thotë se automjetet nuk shfrytëzohen njësoj. Për pasojë kosto për njësi e automjeteve është e ndryshme, më e lartë për ato që shfrytëzohen më rrallë e më e ulët për ato që shfrytëzohen më shumë. Kostoja e shfrytëzimit të automjetit të parë ishte 0.57 euro për kilometër të kaluar ndërsa 0.17 euro për km për automjetin që kishte bërë 85,790 km rrugë. Kjo do të thotë se automjeti që është shfrytëzuar më shumë ka siguruar vlerë më të lartë për para krahasuar me atë që është shfrytëzuar më pak.

Tabela 20: Automjetet e marra me qira nga Zyra e Kryeministrit

Data e fillimit te kontratës	Kilometrat e kaluara	Shpenzimet e qirasë deri me 31-10-2020	Shpenzimet për km
20.03.2018	154,162	14,939	0.10
20.03.2018	98,383	14,939	0.15
10.09.2020	2,909	498	0.17
21.07.2020	8,700	1,494	0.17
09.03.2018	73,575	14,939	0.20
09.03.2018	64,494	14,939	0.23
09.03.2018	62,927	14,939	0.24
Gjithsej	465,150	76,685	0.18

Me automjetet që ZKM-ja i kishte marrë në mars të vitit 2019, i kishte kaluar gjithsej 465,150 kilometra që mesatarisht i bie 0.18 euro për kilometër të kaluar. Ndërsa mesatarja e kilometrave të kaluara për automjet ishte 90,708 km.

Nga analiza e dy raporteve që kemi marrë nga këta shfrytëzues të KC-ve shihet se automjetet e marra me qira kishin kaluar prej rreth 26,000 deri në 154,000 kilometra për 31 muajt e parë të shfrytëzimit të kontratës, ndërsa qiraja për secilin prej tyre është e njëjtë. Kjo do të thotë se kostoja për njësi (kilometër të kaluar) për shfrytëzim të automjeteve dallon shumë, i pari ka koston 0.57 euro për kilometër ndërsa i fundit vetëm 0.1 euro për kilometër.

Në mungesë të një monitorimi të këtillë mbi shfrytëzimin e automjeteve nga ana AQP-së, pa i liruar edhe shfrytëzuesit e KC-ve nga kjo përgjegjësi, mund rezultojë me mungesë informacioni lidhur me atë se a duhet apo nuk duhet të nisët aktivitetet e ri i prokurimit për këtë shërbim kur të skadojë kontrata aktuale.

Nëse vazhdohet me këtë trend të shfrytëzimit të automjeteve, pritet që deri në përfundim të kontratës (edhe 35 muaj) secili automjet të kalojë mesatarisht rreth 150,000 kilometra gjithsej përderisa do të jenë më pak se 6 vite të vjetra, ndërsa deri në atë kohë për një automjet të tillë do të paguhet në emër të qirasë afër 33,000 euro.

AQP-ja nuk ka kryer monitorim efektiv të kontratës së centralizuar **për shfrytëzimin e fotokopjeve dhe printerëve me qira**. AQP-ja nuk ka të vendosur një sistem të duhur për monitorim të zbatimit të kontratës në nivel të përgjithshëm ose në nivel të shfrytëzuesit individual të KC-së. Raporti nuk ishte dizajnuar ashtu që të jap të dhëna të mjaftueshme mbi shfrytëzimin e kontratës. Pos vlerës së realizimit deri në datën e caktuar, raportit i mungojnë të dhënat mbi shfrytëzimin e kontratës nga shfrytëzuesit e KC-ve, nuk përmban ndonjë analizë mbi atë se sa për qind e kontratës ishte realizuar në përgjithësi, apo në veçanti për secilin shfrytëzues të përfshirë në kontratë. Prandaj raporti i dizajnuar nga AQP-ja nuk siguron monitorim efektiv të zbatimit të kontratës.

Nga analiza e raporteve të pranuar mbi realizimin e kontratës (me informacione mjaft të mangëta) kemi konstatuar se për 19 muaj (prej 1 prill 2019 deri 05 nëntor 2020) të zbatimit të kontratës 13 OB-të e përfshira në kontratë kishin shpenzuar vetëm 30,433 euro nga gjithsej 357,000 euro të

kontraktuara, pra është realizuar më pak se 9% e vlerës së kontratës. Pjesa e mbetur prej 91% mbetet të realizohet për 55 muaj, sa kanë mbetur deri në përfundim të kontratës.

Për kontratën **furnizim me mish** dhe produktet e mishit, AQP-ja na ka ofruar një raport të përgjithësuar të realizimit i cili përfshinë sasinë e parashikuara kundrejt atyre të realizuara për produkt (të shprehur në vlerë dhe përqindje). Ky raport nuk tregon sasinë e blerë nga secili nga pesë shfrytëzuesit e kontratës. Në mungesë të kësaj informate nuk dihet se cili shfrytëzues ka ngecje në realizim të kontratës në raport me sasinë e kërkuara fillimisht. Si rrjedhojë, raporti i pranuar nga OE-të mund t'i shërbejë AQP-së vetëm për të konstatuar ecurinë/ngecjen e realizimit në nivel të kontratës e jo edhe kundrejt pjesëve përkatëse të secilit shfrytëzues.

Sipas këtij raporti, për 17 muaj të zbatimit të kontratës ishin shpenzuar vetëm 914,253 euro nga 5,496,397 euro të kontraktuara, do të thotë se realizimi i kontratës ishte vetëm 17%. Rreth 83% e kontratës kishte mbetur të realizohet brenda 24 muajve të ardhshëm.

Edhe pse kontrata nuk ishte duke u zbatuar sipas planit, nuk kemi dëshmi që AQP-së kishte kontaktuar shfrytëzuesit e kontratës për t'u interesuar lidhur me ngecjen dhe eventualisht për të marrë veprime korigjuese.

Formati i raportit që e kishte dizajnuar AQP-ja nuk ishte adekuat për monitorim efektiv prandaj të dhënat në raport nuk ishin të mjaftueshme për të bërë analizë të hollësishme mbi progresin e KC-së.

Mungesa e raporteve adekuate me të dhëna gjithëpërfshirëse kishte për pasojë informacion jo adekuat sa i përket ecurisë së zbatimit të kontratës. Në këtë gjendje, AQP-ja nuk do të jetë e aftë të marrë veprime korigjuese në drejtim të zbatimit të kontratës.

Me këtë trend të zbatimit të KC-së ekziston rrezik që të mos arrihet vlera prej 70% e obligueshme me LPP. Për kontratën për furnizim me karburant deri tek e cila AQP-ja kishte ardhur duke përdorë procedurën e negociuar, të imponuar nga urgjenca për furnizim, meqë KC-së paraprake i kishte skaduar afati 36 mujor, AQP-ja nuk kishte kërkuar fare raportim nga OE-ja lidhur me zbatimin e saj. Me këtë kontratë ishin paraparë të bliheshin mbi pesë milion litra karburant brenda gjashtë muajve, mirëpo në mungesë të raportimit nuk dihet se sa litra gjithsej ishin blerë.

Sa i përket pragut dhe tavanit të përcaktuar prej +/-30% për kontratë/llot/pozicion/artikull Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik e kishte lëshuar një njoftim në shtator 2020, sipas të cilit AK-ja mund të **furnizohet më shumë se që është specifikuar në kontratat** që janë në fuqi dhe **nuk është i obliguar të porositë për të arritur 70% të sasisë së kontraktuar**. Megjithatë AK-ja, me marrëveshje miqësore me OE-të, duhet të bëjnë amandamentimin e kontratave në fuqi për t'i përshtatur me nevojat aktuale si rezultat i forcës madhore.

4 Konkluzionet

Bazuar në analizat tona, kemi arritur në përfundim se prokurimet për kontratat e centralizuara nuk ishin planifikuar si duhet. Kjo kishte ndodhur kryesisht për shkak se ishin mbivlerësuar nevojat të cilat i kishin deklaruar shfrytëzuesit e paraparë të kontratave. AQP-ja nuk i kishte vërtetuar deklaratimet e tyre formalisht përmes Deklaratës së nevojave dhe disponueshmërisë së mjeteve e cila shërben si mjet kontrolli në çdo prokurim publik, edhe në prokurimet me vlerë të vogël, por nuk ishte përdorë as në rastin e prokurimeve të centralizuara, ku kontratat kanë vlerë prej miliona eurove. Për pasojë katër kontrata të centralizuara nuk ishin realizuar siç ishin kontraktuar, bile as nuk e kishin arritur pragun e paraparë me ligj prej 70% të vlerës së kontraktuar. Megjithatë, mos realizimi i këtyre kontratave në nivel të pritshëm nuk kishte ndonjë pasojë financiare për AQP-në e as për shfrytëzuesit e kontratave të centralizuara (KC) sepse AQP kishte arritur marrëveshje miqësore me OE-të.

Aspekt tjetër i planifikimit të prokurimit që nuk ishte bërë siç duhet ishte hulumtimi jo adekuat i tregut. AQP-ja nuk kishte marrë parasysh kontratat individuale të shfrytëzuesve të kontratave të centralizuara, e as nuk kishte bërë hulumtim adekuat për çmime të tregut, duke e anashkaluar tërësisht si hap në proces. Për pasojë kishte sjellë disa kontrata të centralizuara që përmbanin disa artikuj me çmime më të larta krahasuar me çmimet e kontratave të pavarura. Kjo do të thotë se AQP nuk e kishte arritur tërësisht potencialin për kursim.

Krahasimi i çmimeve të tri KC-ve në vlerë të përgjithshme prej 19,152,835 euro, me artikujt e kontratave individuale (KI) që ne kemi pasur mundësi t'i krahasojmë, ka rezultuar se totali i kursimeve të realizuara ishte 477,510 euro ndërsa iu kishte shkaktuar kosto shtesë prej 104,490 euro.

Përveç kësaj, AQP-ja do të mund të kursente edhe 544,306 euro shtesë sikur çmimet e KC-ve të ishin së paku të njëjta me çmimet më të ulëta të kontratave individuale. Me këtë, kursimi total që do të rezultonte nga prokurimet e centralizuara do të arrinte mbi 1 milion euro që paraqet mbi 5% të shumës së shpenzuar në këto tri KC.

AQP-ja kishte arritur kursime me kontratën për furnizim me karburant, çmimi i premiumit në KC ishte më i ulët se çmimi i KI-së të secilit shfrytëzues kështu që ishte arritur kursim total prej 315,562 eurove, për mbi 10 milion litra karburant që kishin blerë shtatë shfrytëzuesit më të mëdhenj të KC-së.

Sa përket furnizimit me letër, kontrata e centralizuar u kishte sjellë kursime disa shfrytëzuesve – gjithsej 27,178 euro, e disa tjerëve ju kishte sjellë shpenzime shtesë, gjithsej 27,856 euro. Në total kjo KC kishte sjellë 678 euro shpenzime shtesë për sasi të kemi analizuar.

Kontrata e centralizuar për furnizim me goma i kishte sjellë kursime prej 236,786 eurove njërit prej shfrytëzuesve më të mëdhenj të kontratës si dhe një shfrytëzuesi tjetër 2,473 euro, në total 239,259 euro. Në anën tjetër njërit shfrytëzues i kishte sjellë shpenzime shtesë prej 76,633 euro për shkak se

çmimet e KC-së ishin më të larta krahasuar me çmimet e KI-së së këtij shfrytëzuesi. Kursimi neto nga KC-ja për furnizim me goma ishte 162,869 euro.

Ndërsa do të mund të kurseheshin edhe 544,306 euro sikur AQP-ja gjatë përcaktimit të vlerës së parashikuar të kontratës t'iu kishte referuar çmimeve më të ulëta të kontratave individuale. Kështu vlera e parashikuar do të ishte më e ulët se ajo që e kanë përcaktuar dhe do të siguronte çmime më të lira të artikujve përkatës. Kursim prej 317,543 euro që do realizohej sikur çmimi i kontraktuar i karburantit (premiumit) në KC të ishte i njëjtë me çmimin e kontratës paraprake të AQP-së, pastaj kursimi prej 75,247 euro që do realizohej sikur letra A4 të kishte çmim të njëjtë me çmimin e kontratës individuale të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe 151,516 euro do të mund të kurseheshin sikur çmimet e artikujve të caktuar të materialit zyrtar të ishin të njëjta me çmimet më të ulëta të kontratave individuale.

Në përgjithësi, në raport me çmimet e tregut, për aq sa ishim në gjendje të sigurojmë çmimet e tregut, kontratat e centralizuara ishin më ekonomike. Mirëpo meqë AQP-së i kishte munguar paraprakisht një hulumtim adekuat i tregut, krahasimi i shumicës së KC-ve me çmimet e tregut ishte i pamundur të realizohet dhe të kuantifikohet.

Kursimet, përkatësisht kostot shtesë të shkaktuara nga prokurimi i centralizuar, qoftë në raport me KI apo me çmimet e tregut, nuk ishin të njohura për AQP-në për shkak se AQP-ja, në mungesë të të dhënave bazuar në hulumtim adekuat të tregut, nuk kishte bërë analiza krahasuese për të gjetur se a ia vlen të vazhdohet me prokurim të centralizuar apo jo.

Mos njohuria për kostot shtesë/kursimet kishte ndodhur për shkak se AQP-ja nuk ishte siguruar se po pranonte raporte të sakta nga OE-të dhe se nuk i kishte analizuar ato fare. Monitorimi i zbatimit të kontratave të centralizuara është i domosdoshëm sepse mund të përdoret si mjet kontrolli që i jep mundësi AQP-së të parandalojë ose të korrigjojë veprimet e shfrytëzuesve të kontratës në rast se ata nuk e shfrytëzojnë kontratën në përputhje me kushtet e saj. Për shkak të monitorimit jo-efektiv kontrata e centralizuar për furnizim me karburant e kishte tejkalar sasinë e parashikuar me më shumë se 41%. Me këtë AQP-ja i kishte privuar OE-të nga shansi për të fituar këtë sasi të tejkalar duke mos e nisur aktivitetin e prokurimit me kohë.

Edhe pse tetë kontrata të centralizuara ishin audituar që kishin rezultuar me një raport të auditimit, të publikuar në vitin 2018, AQP nuk i kishte marrë parasysh sa duhet rekomandimet e Zyrës Kombëtare të Auditimit. Ndër to kishte qenë rekomandimi për analizën kosto-përfitime që duhej bërë para çdo aktiviteti të ri të prokurimit e në veçanti për prokurimet e centralizuara që zhvillohen për herë të parë. AQP nuk e kishte marrë parasysh këtë rekomandim, e që kishte për pasojë fillimin e aktiviteteve të prokurimit për kontratat të reja pa informacion adekuat mbi efektin e mundshëm të prokurimit të centralizuar.

Njësoj sikurse edhe në kontratat e para të centralizuara, AQP nuk kishte bërë analizën e kosto-përfitimeve që normalisht do duhej t'i paraprinte vendimit për inicim të prokurimit të centralizuar. Në bazë të konkluzionit të nxjerrë nga analiza do të duhej të merrej vendimi a të vazhdohet me

prokurim të centralizuar apo jo. Në mungesë të kësaj analize, AQP-ja nuk ka njohuri mbi efektin që ka arritur prokurimi i centralizuar e për pasojë nuk ka njohuri se a është arritur vlerë për para apo jo.

Për KC-në - furnizim me mish, njësoj sikurse edhe për kontratat e para të centralizuara, AQP-ja nuk e kishte hulumtuar tregun duke arritur në situatë kur kishte pranuar çmimet e ofertave ashtu siç kishin ardhur, pa e pasur një çmim referent real.

Për KC-të - shfrytëzimi i fotokopjeve me qira- AQP-ja e kishte bërë planifikimin bazuar në KC-të për furnizim me letër. Kjo e fundit kishte vetëm një vit që ishte nënshkruar dhe si e tillë zbatimit të saj nuk i dihej epilogu. Për më tepër, AQP-së nuk i kishte kontaktuar shfrytëzuesit e kontratës për t'i pyetur as a kanë të kontraktuar aktualisht shërbimin në fjalë dhe nëse po deri kur? Për pasojë KC-të për shfrytëzim të fotokopjes, sikurse edhe kontratat e para të centralizuara, kishte progres të ulët.

Sikurse në kontratat e para të centralizuara, monitorimi i zbatimit të kontratave nuk kishte dhënë ndonjë efekt për arsye se raportet e OE-ve mbi zbatimin e kontratave të reja të centralizuara, ishin edhe më të mangëta se sa ato të mëhershme. Mos lidhja mes planifikimit dhe realizimit për shfrytëzues e bën të pamundur të konstatohet progresi e sidomos në rastet kur raportet e monitorimit nuk përmbajnë të dhëna të detajuara mjaftueshëm. Njohja vetëm e sasisë së realizuar deri në datën e raportimit e mos njohja e shfrytëzuesit të kontratës i jep mundësi shfrytëzuesve të kontratës të bëjnë porosi duke tejkalar kufijtë e përcaktuar me ligj dhe me kontratë ose duke mos arritur pragun e përcaktuar. Duke qenë se shumica e raporteve që AQP-ja pranon nga OE-të për qëllime të monitorimit janë të tilla, (i tillë ishte raporti mbi furnizimin me mish, raporti për fotokopjet dhe raporti për shfrytëzimin e automjeteve me qira) AQP rezulton të ketë mungesë të njohurisë mbi ecurinë e zbatimit të kontratave.

Edhe pse AQP-ja si dhe çdo autoritet kontraktues janë liruar nga përgjegjësia për t'u furnizuar me +/-30% të vlerës/sasisë së kontraktuar si pasojë e gjendjes së shkaktuar nga pandemia Covid-19, në mungesë të këtyre informatave AQP-ja nuk do të jetë në gjendje të bëjë amandamentimin e KC-ve për t'iu përshtatur nevojave reale shfrytëzuesve të kontratave.

Gjithashtu AQP-ja nuk do të jetë në gjendje të konstatojë efektet qoftë pozitive apo negative të prokurimit të centralizuar e për pasojë do të vazhdojë të zhvillojë prokurime, efekti i të cilave është i panjohur.

Edhe Ministria e Financave, si autoritet për miratim ose jo të prokurimeve të centralizuara, nuk do të jetë në gjendje të marr vendime të duhura në mungesë të informacionit të besueshëm e të bazuar në fakte.

5 Rekomandimet

Me qëllim të përmirësimit të procesit të prokurimit të centralizuar dhe shfrytëzimit më ekonomik të buxhetit, ne kemi dhënë rekomandime për Agjencinë Qendrore të Prokurimit si përgjegjëse për zhvillimin e procedurave të prokurimit dhe monitorime të kontratave të centralizuara.

Rekomandojmë Ministrin e Financave, Transfereve dhe Punës të siguroj që Agjencia Qendrore e Prokurimit:

- Komunikon dhe dokumenton formalisht komunikimin me shfrytëzuesit e paraparë të kontratës për t'u siguruar se nevojat e deklaruara të tyre të jenë sa më reale, të mbështetura në analiza nga të dhëna historike dhe në zhvillimet e pritshme në të ardhmen, dhe se ato korrespondojnë me buxhetet e tyre përkatëse;
- Avancën hulumtimin e tregut (analizën të kontratave aktuale dhe paraprahe) për t'u siguruar që parashikimi i çmimit të artikujve të jetë i saktë dhe që do të shpie në një planifikim më të mirë të aktivitetit të prokurimit;
- Avancën hulumtimin e tregut (për aq sa është e mundur) për të konstatuar çmimet e arritshme në treg në bazë të së cilës (në kombinim me analizën e çmimeve të kontratave paraprahe) përcakton çmimet që janë të pranueshme për një prokurim të përmasave të mëdha, siç është prokurimi i centralizuar;
- Para se të nisë aktivitetin e ri të prokurimit, sidomos për prokurimet që zhvillohen për herë të parë, të bëjë analizë të kosto-përfitimeve për të siguruar informacion të mjaftueshëm dhe të përshtatshëm mbi të cilën do të marrë vendimin a të nisë me prokurim të centralizuar apo jo;
- Monitoron aktivisht zbatimin e kontratave të centralizuara dhe të krahasojë realizimin e tyre në raport me kontraktimin për t'u siguruar se ato po zbatohen siç duhet, rrjedhimisht të avancojë veprimet korrigjuese. Në veçanti:
 - Forma e raportimit të ofrojë informacion relevant dhe të mjaftueshëm për analizë;
 - Të sigurohet se të dhënat e raportuara nga OE-të janë të sakta si dhe të kërkojë nga menaxherët përkatës të raportojnë lidhur me zbatimin e kontratës e pastaj të harmonizojë të dhënat e palëve; dhe
 - Të kërkojë nga menaxherët që të raportojnë çfarëdo devijimi nga kushtet e kontratës për t'i dhënë mundësi AQP-së që të intervenojë dhe të bëjë zgjidhjet/korrigjimet eventuale.


- Pas zbatimit të secilës kontratë të bëjë një analizë për të vlerësuar përfitimet eventualisht kostot shtesë që mund të kenë rrjedhë nga prokurimi i centralizuar dhe t' i krahasojë kundrejt atyre që ishin të pritshme bazuar në analizën e kosto-përfitimeve.

Shtojca 1 – Motivi i auditimit, kriteret e auditimit, metodologjia dhe fushëveprimi

AQP-ja kishte zhvilluar, gjatë viteve 2015-2017, 16 aktivitete të centralizuara të prokurimit të cilat kishin rezultuar me 35 kontrata, vlera e përgjithshme e të cilave arrinte mbi 68 milion euro. Tetë prej këtyre kontratave, me vlerë të përgjithshme prej afër 26 milion euro, i kemi audituar dhe gjetjet për to i kemi prezantuar në raportin e auditimit “Vlera për para në prokurimet e centralizuara- pjesa e parë”¹⁹, të publikuar në vitin 2018.

Raporti i vitit 2018 ka identifikuar mangësi në procesin e planifikimit dhe monitorimit të kontratave të centralizuara të cilat për pasojë paraqisnin rrezik për mos arritje të vlerës për para. Së paku katër kontrata, tri prej të cilave me vlerë individuale mbi 2 milion euro, ishin në nivel të ulët të realizimit sa që mund të mos e arrinin pragun prej 70% të kontratës, të paraparë me ligj²⁰.

Grafiku 3: Realizimi i kontratave të centralizuara 15-20 muaj pas nënshkrimit



Mos arritja e këtij pragu paraqiste rrezik që operatorët ekonomik të padisnin AQP-në/Autoritetet kontraktuese shfrytëzuese të kontratave të centralizuara dhe të realizojnë të drejtën e tyre kontraktuese përmes gjykatës. Në kohën kur ne kemi konstatuar këtë gjendje kontratat e centralizuara ishin ende duke u zbatuar, kishin mbetur 16 deri në 21 muaj deri në skadim, prandaj patëm vlerësuar se ka rrezik për mos arritje të vlerës për para. Për të vlerësuar nëse ky rrezik do të materializohej duhej pritur përbushjen e këtyre kontratave apo skadimin e afatit të tyre deri në fund të vitit 2019.

Gjatë viteve 2018-2019, Agjencia Qendrore e Prokurimit kishte lidhur edhe 51 kontrata për furnizime të ndryshme ndër to furnizim me material zyrtar, furnizim me karburant, shërbime të fotokopjimit, shërbime të pastrimit, furnizimi me vetura të udhëtarëve, shërbime të transportit, automjete me qira e tjera. Vlera e përgjithshme e këtyre kontratave është mbi 84 milion euro.

¹⁹http://www.zka-rks.org/wp-content/uploads/2018/05/RaportAuditimit_Vlera-per-para-ne-prokurimet-e-centralizuara.pdf

²⁰ Udhëzim Administrativ Nr. 2/2015, Për Kontratat publike kornizë, që ka hyrë në fuqi me 10/03/2015 <https://krpp.rks.gov.net/krpp/PageFiles/File/Udhezimet%20Adminis%202015/UA%202%202015%20per%20Kontratat%20Publike%20Kornize.pdf>

Fushëveprimi i auditimit

Ky auditim ka mbuluar periudhën 2016-2019 dhe ka përfshirë:

- 1) Sa i përket pyetjes së parë, fushëveprimi i auditimit ka përfshirë tetë kontrata të centralizuara që i kemi audituar fillimisht në vitin 2016-17 me vlerë të përgjithshme prej afër 26 milion euro;
- 2) Sa i përket pyetjes së dytë mbi mësimet e nxjerra, kemi audituar katër kontrata të reja të cilat AQP i ka lidhur gjatë viteve 2018-2019, vlera e përgjithshme e të cilave është afër 12 milion euro ose mbi 11% e vlerës së përgjithshme të kontratave të lidhura gjatë këtyre dy viteve.

Qasja e auditimit/Kriteret e Auditimit

Për të arritur objektivin e auditimit, kemi formuluar pyetjet:

1. A është arritur vlera për para në prokurimet e centralizuara?
 - 1.1. A janë furnizuar shfrytëzuesit e kontratave në përputhje me nevojat e specifikuar në kontrata të centralizuara?
 - 1.2. A janë çmimet e produkteve të furnizuara më të lira krahasuar me çmimet në kontrata të pavarura?
 - 1.3. A janë çmimet e produkteve të furnizuara të përafërta me ato të tregut?
 - 1.4. A ka bërë vlerësim të duhur të përfitimeve dhe kostove nga aktivitetet e centralizuara të prokurimit?
2. A janë shfrytëzuar si duhet, mësimet e nxjerra nga VpP, (pjesa e parë) në prokurimet e reja të centralizuara?
 - 2.1. A janë vlerësuar si duhet përfitimet e mundshme nga aktivitetet e reja të centralizuara të prokurimit?
 - 2.2. A e monitoron AQP si duhet zbatimin e kontratave?

Kriteret e auditimit:

Për të përkufizuar më qartë se çka nënkupton “si duhet” në nën-pyetjet e mësipërme të auditimit, kemi aplikuar kriteret në vijim të cilat derivojnë nga LPP, Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurim Publik, nga Udhëzimet administrative për prokurimet e centralizuara si dhe nga praktikat e mira:

- 1 Sasitë e specifikuar në kontratë janë pikë referimi gjatë shfrytëzimit të kontratave të centralizuara për t’u arritur vlera për para, pragu dhe tavani i përcaktuar me ligj duhet të respektohen;

- 2 Çmimet e furnizuara me kontrata të centralizuara duhet të jenë më të lira krahasuar me çmimet e kontratave individuale dhe me çmimet e tregut për shkak të ekonomisë së shkallës²¹ (operatorit ekonomik i ulët kosto për njësi e produktit kur i rritet vëllimi i shitjes, rrjedhimisht ka hapësirë për ulje të çmimit);
- 3 Pas zbatimit të kontratave AQP duhet të bëjë analiza për të vlerësuar përfitimet dhe kostot e shkaktuara nga aktivitetet e centralizuara të prokurimit në raport me prokurimet e pavarura. Lidhur me këtë duhet të marrë informacion (feedback) edhe nga shfrytëzuesit e kontratave të centralizuara;
- 4 AQP, si autoritet kontraktues, duhet të dokumentojë në mënyrë të duhur nevojat për blerje²², duke vendos komunikim²³ me organizatat buxhetore që përfshihen në kontrata të centralizuara. Të dhënat që i merr nga to lidhur me llojin dhe sasinë e mallrave²⁴, gjegjësisht vlerën e parashikuar të tyre, duhet t'i konfirmojë duke siguruar Deklaratën e Nevojave dhe Dispozueshmërisë së Mjeteve²⁵ me të cilën zyrtari kryesor administrativ dhe zyrtari kryesor financiar i OB-së përkatëse konfirmon edhe një herë se OB ka nevojë për llojin dhe sasinë përkatëse të mallrave dhe se ka buxhetuar mjete të mjaftueshme për to;

Gjithashtu, AQP duhet të bëjë hulumtim të tregut²⁶ duke bërë analizë të kontratave paraprake për furnizim me mallra të njëjta ose të ngjashme, krahas me këtë duhet të bëjë hulumtim në terren (nëse është e mundur) për t'u siguruar që çmimi kontraktuar nuk është më i lartë se çmimi i tregut;

AQP duhet të bëjë një analizë për të përcaktuar raportin mes kostove dhe përfitimeve të pritshme nga aktivitetet e prokurimit të centralizuar në raport me prokurimet e pavarura. Në këtë kontekst AQP duhet të zgjedhë procedurën e duhur të prokurimit, për mallra të konsumit të përbashkët (zakonshme) preferohet procedura e hapur ndërsa kriteri më i përshtatshëm për dhënie të kontratës është "çmimi më i ulët". Për mallra që kanë kosto të operimit dhe mirëmbajtjes aplikimi i kriterit "tenderi ekonomikisht më i favorshëm" është më i përshtatshëm; dhe

- 5 AQP duhet të monitorojë progresin e kontratave²⁷ duke siguruar rregullisht raporte mbi zbatimin e tyre, dhe sipas nevojës, në rast se zbatimi nuk shkon sipas planit, duhet të kontaktojë menaxherët përkatës të kontratave për të marrë veprime korrigjuese.

²¹ Sigma papers No. 47, fq 18, 56 dhe 63, Brief 20 Central Purchasing Bodies faqe 4

²² Ligji Për Prokurim Publik Neni 9 Përcaktimi i nevojave që duhet përmbushur, pika 1 dhe 2

²³ Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ Për Prokurimin Publik Neni 5. Planifikimi i Prokurimit pika 5.19

²⁴ Udhëzim Administrativ (QRK) Nr.05/2016 për Zbatimin e Procedurave Qendrore të Prokurimit Publik Neni 6, Obligimet e autoriteteve kontraktuese, pika 3

²⁵ Udhëzim Administrativ (QRK) nr. 03/2017 për plotësimin dhe ndryshimin e Udhëzimit Administrativ (QRK) nr. 05/2016 për zbatimin e procedurave qendrore të prokurimit publik Neni 4.

²⁶ Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik Neni 4. Administrimi i përgjithshëm i procedurave të prokurimit Pika 4.2 nën c)

²⁷ <http://www.sigmaweb.org/publications/Public-procurement-Brief-11-2016-Albanian.pdf> faqe 5 paragrafi 1

Metodologjia e auditimit

Pyetjeve të auditimit iu kemi përgjigjur duke:

- Krahasuar sasi të e furnizuara me ato të planifikuara për të konstatuar nëse ka diferenca substanciale;
- Krahasuar çmimet e një numri të caktuar të artikujve të kontratave të centralizuara (të zbatuara plotësisht) me çmimet e kontratave individuale të OB-ve (për shfrytëzuesit më të mëdhenj të kontratave të centralizuara). Krahasimi i të njëjtave është bërë edhe me çmimet e tregut (për aq sa kemi pasur mundësi të sigurojmë);
- Vlerësuar nëse AQP-ja i ka bërë si duhet analizat krahasuese për përfitimet dhe kostot nga aktivitetet e prokurimit të centralizuar. Këtu përfshihet edhe krahasimi i çmimeve të kontratave centralizuara me çmimet e kontratave paraprake të OB-ve që i kanë lidhur në mënyrë individuale;
- Vlerësuar nëse AQP-ja ka bërë si duhet vlerësimin e përfitimeve të pritshme nga aktivitetet e reja të prokurimit të centralizuar (duke përfshirë identifikimin sa më të saktë të nevojave, hulumtimin e tregut, parashikimin e vlerës së kontratave, kostot e reduktuara të OB-ve për të cilat zhvillon prokurime të centralizuara etj.);
- Analizuar aktivitetet e prokurimit të zhvilluara nga AQP-ja prej publikimit të tenderit deri në lidhje të kontratës (për mostrën e përcaktuar për aktivitetet e reja të prokurimit); dhe
- Analizuar raportet e monitorimit të përgatitura nga AQP-ja mbi realizimin e kontratave.

Shtojca 2 Mostra e kontratave të centralizuara

Tetë kontratat që i kemi audituar në vitin 2017 dhe që kishin afat deri në vitin 2019 janë:

1. Furnizimi me karburante;
2. Furnizimi me letër;
3. Furnizim me material zyrtar;
4. Furnizimi me goma;
5. Furnizim me dru;
6. Furnizim me thëngjill;
7. Furnizim me mazut; dhe
8. Furnizimi me pelet.

Katër kontratat e reja që janë audituar janë:

Titulli i kontratës	Data e nënshkrimit të kontratës	Periudha e kontratës në muaj	Vlera e kontraktuar €
Shfrytëzimi afatgjatë i automjeteve me qira, kat 3, Lot 2	27.03.2018	66	1,281,749
Shërbime të fotokopjimit për nivelin lokal, Lot I .	26.03.2019	66	357,500
Furnizimi me Karburante (Procedurë e Negociuar)	12.02.2019	36	4,795,690
Furnizim me mish dhe produkte te mishit Kategoria 1 Lot 1	19.11.2019	36	5,496,397
Gjithsej			11,931,336

Shtojca 3 Letër konfirmimi/Komentet e Agjencisë Qendrore të Prokurimit si dhe pikëpamjet e Zyrës Kombëtare të Auditimit



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
Ministarstvo za Finansije, Radu i Transfera – Ministry of Finance, Labor and Transfers
Agjencia Qendror e Prokurimit
Centralna Agjencia Nabavka / Central Procurement Agency

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë e pjeshme me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm për raportin “Vlera për para në prokurimet e centralizuara, pjesa e dytë”

Për: Zyrën e Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin Vlera për para në prokurimet e centralizuara, pjesa e dytë (në tekstin e mëtejshëm “Raporti”);
- pajtohem pjesërisht me të gjeturat dhe rekomandimet dhe kemi komente për përmbajtjen e draft Raportit të cilat i gjeni nga faqja 2 e tutje në shtojcën; si dhe
- presim që komentet tona të analizohen nga ana juaj dhe të ndryshohen disa pika të draft raportit.
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t’ju dorëzoj një plan të veprimit për implementimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.

Z. Behxhet Rrudqi

Zv.Drejtor i Agjencisë Qendrore të Prokurimit,

Data: 17.06.2021, Prishtinë,

Të gjeturat/ çështjet	Pajtohemi po/jo	Komentet e OB në rast të mospajtitimit	Pikëpamjet e ZKA-së
<p>Çështjet 1: Faqe 4. Mirëpo, meqë jo të gjithë artikujt në kontrata të centralizuara ishin me çmime më të ulëta se çmimet e artikujve përkatës në kontrata individuale, Agjencia Qendrore e Prokurimit nuk iu kishte siguruar kursime buxhetore disa organizatave buxhetore, përkundrazi iu kishte shkaktuar shpenzime shtesë.</p>	<p>JO</p>	<p>Vlerësimi i ofertave në mënyrë që secili artikuj të jetë me çmim më të ulët se në kontratat paraprake të ndonjë institucioni në RKS nuk ka bazë ligjore. Pra kjo nuk mund të realizohen pasi që nuk lejohet ligjërisht të refuzohet një oferte nëse çmimin për një artikull e ka më të lartë se një kontratë tjetër paraprake, gjithashtu nuk keni marrë në konsideratë lëvizjet e çmimit të tregut. Lëvizjet e çmimit të tregut duhet çdo herë të merren për bazë kur krahasohen dy kontrata të njëjta në periudha të ndryshme, kjo mund të ketë ndikim pozitiv apo negativ në vlerën e kursimeve të KC por duhet të merret për bazë.</p>	<p>Sipas Rregullave dhe udhëzuesit operativ për prokurimin publik, pika 11.1.b.percakton që zyrtari përgjegjës i prokurimit “siguron që mallrat, shërbimet dhe punët blihen në mënyrën më ekonomike, efikase dhe efektive”. Gjithashtu, pika 13.2, në parashikimin e vlerës së kontratës, AK duhet: “të merren parasysh çmimet e publikuara nga Zyra e Statistikave të Kosovës dhe/ose çmime tjera indikative zyrtare (të tilla si zyra tatimore, zyra e doganave, oda ekonomike, etj); dhe/ose, çmimet e tregut lokal; dhe/ose, çmimet e kontratave paraprake të nënshkruara nga autoriteti i njëjtë apo tjetër kontraktuese; dhe/ose, çmime ndërkombëtare të publikuara; dhe/ose, çmimet për njësi të publikuara në webfaqe të KRPP-se.</p> <p>Nëse vlera e parashikuar e kontratës do të bazohej në çmimet e kontratave paraprake të nënshkruara nga AK tjera do të ishte më e ulët e rrjedhimisht do të siguronit çmime me të ulëta.</p> <p>Edhe mund të ketë pasur lëvizje në nivelin e përgjithshëm të çmimeve ju nuk e keni dokumentuar këtë ngritje për të arsyetuar vlerën e parashikuar të kontratës bazuar në çmimet e ngritura.</p>

<p>Çështjet 2: Faqe 4.</p> <p>Kjo formë e prokurimit kishte rezultuar me 105 mijë euro shpenzime shtesë për disa organizata buxhetore sepse çmimet e artikujve të caktuar në kontratat e centralizuara ishin më të larta se çmimet e artikujve përkatës në kontrata individuale.</p>	JO	<p>Në shumë raste në draft raport ceket shpenzimet shtese dhe këtë Ne nuk e pranojmë pasi që nëse analizohet edhe vetë raporti i juaj rezultatet dalin që KC sjellin kursime dhe nuk ka kuptim që e njëjta kontratë të sjellë edhe kursime edhe shpenzime shtesë.</p>	<p>Për ta paraqitur gjendjen në mënyrë objektive përveç që i kemi prezantuar kursimet që kanë rrjedhë nga kontratat e centralizuara, kemi prezantuar edhe kostot shtesë dhe metodologjia e përdorur ka qenë e njëjta në të dyja rastet.</p> <p>Analiza jonë ka konkluduar se ka pasuar kursime për disa OB (shumicën) por ka pasur edhe kosto shtesë për disa OB tjera (një numër më të vogël si SKGJK-letër, MM – goma, SHKK-mish). Analizat paraprake bëhen për këtë qëllim (sipas LPP 1.10. Artikuj të përdorimit të përbashkët - prodhimi ose shërbimi i kërkuar nga një ose më shumë autoritete kontraktuese, për të cilat mund të arrihet përdorimi më efikas dhe me kosto ekonomike i fondeve publike me anë të zhvillimit të prokurimit qendror, të përbashkët ose të konsoliduar.</p>
<p>Çështjet 3: Faqe 5.</p> <p>Përveç kursimit prej 477 mijë eurove, Agjencia Qendrore e Prokurimit do të mund të kursente edhe afër 514 mijë euro sikur gjatë përcaktimit të vlerës së parashikuar të kontratës t'iu kishte referuar çmimeve më të ulëta të kontratave individuale. Kështu vlera e parashikuar do të ishte më e ulët se ajo që e kanë përcaktuar dhe do të siguronte çmime më të lira të artikujve përkatës.. Me këtë, kursimi total që do të rezultonte nga prokurimet e centralizuara do të arrinte mbi një milion euro që paraqet mbi 5% të</p>	JO	<p>Nuk ka bazë ligjore të vlerësohen ofertat në këtë mënyrë. Por gjithsesi nëse themi që kursimet do të mund të ishin edhe afër 514 mijë € në të njëjtin rast Ne mund të kalkulojmë se sa buxhet do të shfrytëzohej nëse produktet që janë blerë me kontrata të centralizuara do të bliheshin me KI që kishin çmimet me të larta dhe kursimet do të arrinin në disa milion €, kështu që ky kalkulim nuk është real dhe nuk është i saktë.</p>	<p>Për të qenë edhe më të qartë kemi riformuluar paragrafin në fjalë për ta sqaruar se theksi është venë tek vlera e parashikuar e kontratës e jo tek vlerësimi i ofertave. Kalkulimi i kursimeve që ka realizuar AQP tanimë është bërë dhe është potencuar në raport (477 mijë euro). 514 mijë euro shtesë do të kurseheshin sikur gjithë artikujt e blerë do të ishin me çmimet më të ulëta të KI-ve. Çështja është se me një analizë më të mirë – identifikim të çmimeve paraprake më të ulëta të arritshme – dhe parashikim të vlerës së kontratës bazuar në këto çmime do të arriheshin çmime më të mira dhe kursime shtesë.</p>

buxhetit të shpenzuar në vetëm tri kontrata të centralizuara.			
<p>Çështjet 4: Faqe 5.</p> <p>Mungesa e monitorimit efektiv kishte bërë që Agjencia Qendrore e Prokurimit të mos ndërmarr veprime korigjuese kur kontratat nuk ishin duke u zbatuar siç ishin paraparë.</p>	JO	<p>AQP kryen monitorim efektiv dhe kjo dëshmohet me atë që të gjitha kontratat e analizuara nga ana juaj e që janë të përfunduara janë përmbyllur me sukses dhe për asnjërën nuk ka pasur penalizime për AQP-në apo institucionet publike.</p>	<p>Monitorimi ka nevojë për përmirësim, siç e kemi cekur edhe në faqe 25:</p> <p>“Me qëllim të monitorimit, AQP-ja kishte hartuar formularë në formatin Excel, të cilët kontraktuesit (OE-të) e kishin përgjegjësi t’i plotësonin dhe dërgonin tek AQP-ja. Mirëpo, formularët si të tillë, përmbajnë mundësi të madhe për regjistrime të gabuara, e për pasojë edhe të dhënat që nxirren nga raportet e tilla mund të mos jenë të plota dhe të sakta. Në këto raporte (p.sh. furnizimi me material zyrtar dhe furnizimi me goma) kemi gjetur se kontraktuesi e kishte regjistruar artikullin e njëjtë me çmime të ndryshme. Gabim tjetër që kemi gjetur në këta formularë është se shfrytëzuesit e kontratës ishin regjistruar me emra të ndryshëm, pastaj edhe nën-njësitë organizative të shfrytëzuesve të kontratës paraqiteshin në raport që e kishte komplikuar edhe më tepër monitorimin e zbatimit të kontratë.”</p> <p>Sikur monitorimi nga ana e AQP-së të ishte efektiv nuk do të vinte deri të tejkalimi i vlerës së kontratës për furnizim me karburant me 41% ose me 11% prej tavanit të lejuar.</p>
<p>Gjetja 3: 3.1.4 faqe 25</p> <p>Shkaktar për mungesën e rezultateve të besueshme të zbatimit të KC-ve ishte mos përdorimi i një metode të duhur të analizës së prokurimit të</p>	JO	<p>Cilat janë faktet që nuk ishte metodat e duhur dhe cila është metoda e duhur? Së bashku me raportin e auditimit ju duhet të na sqaroni se çfarë metoda duhet përdorur nëse ato te përdorur nga ana jonë nuk janë të duhura.</p>	<p>Siç është cekur edhe në raport, AQP nuk ka bërë analizë lidhur me kontratat e centralizuara që janë zbatuar plotësisht.</p> <p>Për një analizë të besueshme, duhet të merren parasysh çmimet referente (çmimet e kontratave individuale ose</p>

<p>centralizuar nga ana e AQP-së. Në mungesë të këtyre informatave AQP-ja kishte përsëritur aktivitetet e prokurimit të sapo përfunduara pa ditur nëse ia vlen të vazhdohet me prokurim të centralizuar apo jo.</p>		<p>Pasi që sipas ju AQP ka përsëritur aktivitetet e prokurimit pa analize atëherë Ne besojmë që ju keni kryer analizat në mënyrën e duhur dhe duhet të rekomandoni vazhdimin apo jo të procedurave të cilat i keni analizuar.</p> <p>AQP nuk përsërit aktivitetet e përfunduara por udhëheqë procedurat me të cilat obligohet nga Vendimet e Qeverisë.</p>	<p>çmimet e tregut) të dhënat e raportuara nga OE-të duhet të jenë të sakta (me kontrolle në aplikacionet për raportim).</p>
<p>Gjetja 5: Faqe 32.</p> <p>Mos hulumtimi adekuat i tregut ka bërë që AQP, përkundër sasive dukshëm më të mëdha që përmban kontrata e centralizuar, të mos arrij të kontrakttoj çmim më të volitshëm se çmimet e përfituara me KI, të paktën për artikujt që janë paraparë të blihen më së shumti dhe që marrin pjesën më të madhe të shpenzimit.</p>	JO	<p>Kjo nuk është gjetje ky është mendim apo supozim qe nuk paraqiten faktet.</p>	<p>Siç është cekur në raport çmimi i mishit me KC është më i lartë se çmimi i tij me KI. Sasia e KC që ishte 536,460 kg është dukshëm më e lartë se sasia e KI 18,000 kg, prandaj vet fakti që sasia është shumëfishuar do duhej të siguronte çmim më të ulët, pavarësisht ngritjes së çmimit të tregut. (ngritja çmimit të mishit nuk është dokumentuar nga AQP kur është përcaktuar vlera e parashikuar e kontratës).</p>
<p>Gjetja 5: Faqe 33.</p> <p>AQP-ja kishte pranuar raporte nga OE-ja por edhe ato nuk ishin dizajnuar mirë sepse përmbanin vetëm të dhëna se cili shfrytëzues i posedonte automjetet e kontraktuara e asgjë lidhur me kilometrat e kaluara të automjeteve, për servisimet apo riparimet e automjeteve.</p>	JO	<p>Raportet janë të dizajnuara sipas kërkesave të kontratës, ndërsa kilometrat e kaluara nuk reflektojnë në kontrate dhe nuk janë të cekura në kontrate për këtë arsye nuk kërkohen në raporte. Nëse km e kaluara kanë ndikim të theksuar sipas analizës tuaj ju lutem të rekomandoni atë.</p>	<p>Kontratën e ka dizajnuar AQP, nëse kilometrat nuk janë të reflektuara në kontratë, AQP është përgjegjëse për t'i përfshirë ato, prandaj nuk mund të arsyetoni mungesën e të dhënave duke u bazuar në kontratë. Kilometrat e kaluara gjithsesi kanë ndikim për shkak sepse s'ka kurrfarë arsye ekonomike - s'ka vlerë për para - nëse për një automjet paguhet qira afër 33,000 euro ndërsa i kthehet qiradhënësit me vetëm 55,000 kilometra të kaluara, praktikisht i papërdorur. Shuma prej 33,000 euro është ekuivalent me çmimin për blerje të automjetit.</p>

<p>Gjetja 6: Faqe 34</p> <p>Nëse vazhdohet me këtë trend të shfrytëzimit të automjeteve, pritet që deri në përfundim të kontratës (edhe 35 muaj) secili automjet të kalojë mesatarisht rreth 150,000 kilometra gjithsej përderisa do të jenë më pak se 6 vite të vjetra, ndërsa deri në atë kohë për një automjet të tillë do të paguhet në emër të qirasë afër 33,000 euro.</p>	JO	<p>Kjo nuk është gjetje pasi që çmimi i qeras që do të paguhet është në kontrate dhe është vlera e sakte 497.96€/muaj apo 32,865.36€ për 36 muaj. Ndërsa sa kilometra pritet të kalojnë është vetëm pritshmëri nga ju. Por ju lutem të na sqaroni domethënien e kësaj gjetje të pretenduar nga ana juaj.</p>	<p>Metodologjia e ZKA në këtë raport është që të rrumbullakoj shifrat për të qenë më lehtë të lexueshme. Ndërsa pritshmëria është e bazuar në të dhënat nga 31 muajt e kaluar, që do të thotë afër gjysma e periudhës së kontraktuar.</p>
<p>Gjetja 6.2 Faqe 34</p> <p>Në mungesë të një monitorimi të këtillë mbi shfrytëzimin e automjeteve nga ana AQP-së, pa i liruar edhe shfrytëzuesit e KC-ve nga kjo përgjegjësi, mund rezultojë me mungesë informacioni lidhur me atë se a duhet apo nuk duhet të nisat aktivitetin e ri i prokurimit për këtë shërbim kur të skadojë kontrata aktuale.</p>	JO	<p>Në raportin e auditimit Mirëmbajtja dhe riparimi i automjeteve zyrtare të publikuar nga ZKA në Qershor 2015 keni rekomanduar që Ministria e Financave të përdorë lizingun si mënyrë për kosto më efektive, atë raport Ne e kemi analizuar para fillimit të procedurës së prokurimit për marrje me qira të automjeteve dhe aty nuk keni kalkuluar apo nuk keni rekomanduar që të kalkulohe çmimet për km. Duke u bazuar në atë që ju gjatë perplimit të raportit të auditimit keni kryer analiza të tilla atëherë presim të jepni rekomandime se në çfarë mënyrë të zhvillohet ky aktivitet i prokurimit? Sa km duhet të kalohen që të arrihet vlera për para? A është faktori i vetëm km e kaluara që duhet të kalkulohet? Cili duhet të jetë vlera e parashikuar për 1 km të kaluar? Kontrata e AQP-së bazohet në kohëzgjatjes dhe pagesa e qeras është fikse mujore por nëse ju keni arritur në përfundime që duhet të bazohemi tek km e kaluar atëherë ju lutem të na jepni si rekomandim dhe të na ofroni fakte që Ne të propozojmë që në të ardhmen të zhvillojmë këtë aktivitet të prokurimit në bazë të km të kaluara.</p>	<p>Qëllimi i këtij raporti është të prezantoj gjendjen dhe të ofrojë informata të vlefshme që mund të shërbejnë për përmirësimin e mënyrës aktuale të përgatitjes dhe zhvillimit të aktiviteteve të centralizuara të prokurimit. Gjetjet ju japin një pamje të performancës së AQP-së së cilës i takon të zgjidhë metodat për ta avancuar/përmirësuar performancën.</p>

<p>Gjetja 7. Faqe 28</p> <p>Shkak kryesor për këtë gjendje ishte mungesa e komunikimit adekuat mes AQP-së dhe shfrytëzuesve potencial të kontratës.</p>	JO	<p>Të gjitha Institucionet që janë pjese e dosjeve të tenderit në të gjitha aktivitetet e prokurimit të udhëhequra nga AQP-ja përfshirë këtu edhe aktivitetin e prokurimit: "Shfrytëzimi i automjeteve me qera" bëhen pjesë vetëm pas kërkesës së tyre dhe shkaku kryesor është mos planifikimi i duhur nga ana e tyre dhe AQP nuk ka fare të bëjë me këtë pikë. Këto të gjetura nuk kanë të bëjnë me AQP-në e as komunikimi nuk është shkaku kryesor.</p>	<p>AQP ka komunikuar me Institucionet, mirëpo nuk është siguruar se ato janë zotuar se do ta zbatojnë pjesën e tyre të kontratës. Rast konkret ishte KQZ e cila shumë shpejt pas nënshkrimit të kontratës ishte tërhequr për mungesë të fondeve. Gjetja gjithsesi ka të bëjë me AQP-në, sepse sikur AQP ta identifikonte me kohë paaftësinë e KQZ-së për ta zbatuar kontratën, AQP nuk do ta përfshinte fare në kontratë të centralizuar.</p>
---	----	--	---

<p>Gjetja 8: 3.1.3 faqe 23.</p> <p>Në tabelën e mësipërme shohim se çmimi që kishte arritur AQP ishte më i ulët se çmimi mesatar i tregut i konstatuar nga ASK-ja, megjithatë ky ndryshim për çdo vit ishte reduktuar dukshëm, nga 9% sa ishte në vitin e parë të zbatimit të kontratës së centralizuar në vetëm 2% në vitin e fundit. Megjithatë çmimi i AQP-së ishte i bazuar në bursë dhe çmimi i premiumit nuk kishte pasur lëvizje gjatë viteve të zbatimit të kontratës.</p>	<p>JO</p>	<p>Kjo rënje e diferencës duhet të analizohet pasi që çmimi i KC nuk ka ndryshuar gjatë këtyre 3 viteve, me këtë rast duhet te analizohet se çfarë ka ndodhur në çmimet e publikuara nga ASK-ja. Ne besojmë që të dhënat e publikuara nga ASK-ja duhet të analizohen më thellë pasi që vërehen disa lëvizje të çrregullta për të ju vërtetuar këtë po ju paraqesim disa fakte: Në muajin Janar 2019 çmimi i dizell 10ppm i kalkuluar nga breza pa asnjë tarifë vendore ishte 0.4540€/litër + 0.36 akciza + 18% TVSH = 0.9605€/litër (ky çmim është pa përfshirë asnjë shpenzim siç janë ato të transportit apo premiumin) ndërsa në muajin Shkurt 2019 çmimi për dizell 10ppm ishte 0.4880€/litër +0.36 +18% = 1.0006€, pra këtu shohim që pa përfshirjen e asnjë shpenzimi dallim është 0.04€ në litër (kur përfshihen shpenzimet kjo diferencë rritet pasi që TVSH shtohet pasi ti shtohen çmimit shpenzimet e transportit dhe premiumit) ndërsa në çmimet e publikuara nga ASK-ja çmimi i muajit Janar 2019 është i njëjtë me çmimin e muajit Shkurt 2019, çmimet janë 1.09€/litër për të dy muajt ndërsa në KC çmimet janë Janar - 1.0464€/litër dhe Shkurt - 1.0864€/litër që është diferenca e shatuar nga lëvizja e çmimit në berzen ndërkombëtare. Gjithashtu mund të analizojmë edhe muaj të tjerë siç është rasti tek muaji Shkurt 2017 kur çmimi ishte me KC 1.0232€/litër dhe në muajin vijues Mars 2017 kishte zbritje prej më shumë se 0.03€/litër pasi që çmimi ishte 0.9917€/litër, ndërsa në çmimet e publikuara nga ASK-ja në këta dy muaj nuk ka asnjë lëvizje të çmimit, për këta dy muaj çmimi është 1.02€/litër. Nga muaji Tetor 2018 në muajin Nëntor 2018 kishte zbritje të çmimit me KC prej mbi 0.07€/litër, në Tetor 2018 çmimi ishte 1.1833€/litër dhe në Nëntor 2018 çmimi ishte 1.1104€/litër ndërsa në publikimin e çmimeve të ASK-së në këta dy muaj</p>	<p>ASK është institucion publik, të dhënat e së cilës i marrim si të mirëqena dhe nuk i kontestojmë si të tilla. Përveç kësaj kursimi që ne e kemi konstatuar është në raport me KI të OB-ve shfrytëzuese të KC-së e jo në raport me çmimet e tregut. Ne vetëm kemi prezantuar në raport diferencën mes çmimit të KC-ve dhe çmimit të tregut gjë që është e pritshme jo vetëm në prokurimet e centralizuara por në çdo prokurim publik. Ne nuk e kemi përcaktuar nivelin e kursimit që del nga kjo diferencë. Për me tepër, AQP ka pranuar çmime (oferta) për sasi me shumicë, ndërsa çmimi i raportuar nga ASK është çmimi i konsumit me pakicë.</p>
--	-----------	--	---

		<p>çmimi ishte 1.20€/litër. Duke u bazuar në këto analiza e shohim si problematike që krahasimi i çmimit të KC me çmimet e publikuara nga ASK-ja të konsiderohet si krahasim me çmimet e tregut, këtu mund të ndikojnë shumë faktor por përderisa nuk jemi të informuar saktë se si i kalkuloni çmimet ASK-ja nuk mund të japim konkluzione pse kanë ndodhur këto lëvizje të çrregullta në çmimet e dizellit. Duhet të keni parasysh që kjo kontratë ka qenë për institucionet e nivelit qendror që shumica janë në Prishtinë atëherë ju duhet të kalkuloni çmimin e tregut në Prishtinë.</p> <p>Krahasimi me çmimin e tregut me pakicë është i mundshëm të bëhet në çdo kohë, Ne mund të kalkulojmë në kohë reale në çdo datë se sa do të ishte diferenca në mesë të çmimit të tregut dhe çmimit të kësaj kontrate, sa për ilustrim Ne kemi kalkuluar/krahasuar çmimin e datës 08.04.2021, me këtë datë çmimi i tregut me pakicë ishte 1.07€ për dizell (si dëshmi gjeni te bashkangjitur edhe kuponin fiskal, nuk bëhet fjalë për dizell "Premium" apo "plus", këtë çmim mund ta vërtetoni edhe ju vetë) ndërsa nëse e kalkulojmë çmimin e berzës dhe nëse përdorim tabelën e llogaritje së çmimit që ishte në këtë kontrate atëherë çmimi i datës 08.04.2021 me këtë kontrate do të ishte 0.9474€/litër që është 0.1226€/litër apo afër 13% më lirë.</p>	
<p>Gjetja 9: faqe 19.</p> <p>Krahasimi i kontratës së AQP-së për furnizim me letër ka nxjerrë në pah se AQP kishte kontraktuar çmime më të larta se sa ato që i kishte arritur PK-ja,</p>	<p>JO</p>	<p>Në pjesën e parë të Raportit të auditimit të performancës - Vlera për para në prokurimet e centralizuara të vitit 2018 në analizën e kontratës furnizim me letër ju keni cekur që Policia e Kosovës ka blerë letër A4 me çmim prej 5.5€/ris (grafiku 1 - faqe</p>	<p>Në raportin e parë është paraqitur çmimi i PK-së 5.5€/ris (mirëpo sasia e përafërt vjetore ishte 30 risa dhe ishte letër A4 80 g/m2 me ngjyra) ndërsa kontrata pasuese e vitit 2016, që është lidhur pas kontratës së</p>

<p>Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës (SKGjK) dhe Administrata Tatimore e Kosovës (ATK), që janë tre shfrytëzuesit më të mëdhenj të kontratës. Përveç këtyre janë edhe Zyra e Kryeministrit (ZKM) dhe ShKK-ja që kanë pasur çmime më të lira në kontratat e tyre individuale. Këta pesë shfrytëzues ishin furnizuar me mbi 55% të sasisë totale të letrës A4 të kësaj kontrate dhe të pesëve së bashku kontrata e centralizuar iu kishte kushtuar 27,856 euro më shtrenjtë.</p>	<p>17), ndërsa në draft raportin e dërguar tash nga ju e keni cekur që PK ka blere letër A4 me çmim prej 2.26€/ris. Ju lutem të verifikoni këto të dhëna dhe të sqaroni se çfarë ka ndodhur këtu ? Çfarë nënkuptohet me këto lëvizje të çmimit? Cili çmimi duhet të merret për të krahasuar me KC ?</p> <p>Nëse merret për analizë çmimi e KI të PK të cilin e keni vendosur në pjesën e parë të raportit atëherë kursimet te paraqitura sipas formës se draft raportit ne Tabelën 9 është mbi 300,000€ apo saktë 308,842.70€, gjithashtu nëse merret një mesatare në mes të këtyre dy çmimeve të cekura nga ju për PK atëherë kemi një çmim prej 3.94€/ris dhe kursimet në krahasim me KC sipas Tabelës 9 është mbi 150,000€ . Këtu vërehet që ka shumë rendësi se cilat të dhëna merren parasysh, prandaj nuk mund të merrni vetëm një vlerë të një kontrate të caktuar të një institucioni. Është shumë e rëndësishme të na ofroni të dhënat për këto dy kontrata të PK të cilave ju keni referuar ju, se për çfarë sasi janë lidhur kontratat? Çfarë lloj kontrate kanë qenë? A mund të na dërgoni këto dy kontrata që ti shohim edhe Ne?</p> <p>Në analizën e draft raportit mungon krahasimi me çmimet e tregut e duke pasur parasysh që çmimet e letrës caktohen në nivel ndërkombëtar mund të gjenden të dhëna të ndryshme në internet mbi çmimin e letrës në shtetet e ndryshme të Evropës, një mundësi është edhe web faqja www.statista.com (https://www.statista.com/statistics/613749/average-price-for-din-a4-paper-in-selected-countries-europe/) këtu mund të gjejmë çmimet e letrës në vitin 2014 ne</p>	<p>centralizuar, me të cilën ishin kontraktuar 30,000 risë letër, kishte çmim prej 2.26€ për ris.</p> <p>Siç e kemi cekur më lartë KI e PK-së e raportit të parë kishte vetëm 30 risa letër dhe atë me ngjyra. Krahasimi juaj nuk është i qëndrueshëm për shkak se çmimi i PK-së për kontratën pasuese ishte 2.26 e jo 5.5 euro dhe analiza jonë është bërë bazuar në kontratën pasuese të PK-së që ishte lidhur në kohën kur KC ishte në zbatim</p> <p>KI të cilave iu kemi referuar kanë sasi dukshëm më të vogla se sa KC dhe kanë pasur çmime më të ulëta. Kontratat ua kemi prezantuar dhe ua kemi dhënë numrat e kontratave.</p>
---	---	--

		shtetet e Evropës ku bëjnë pjese edhe disa shtete të rajonit tonë.	
<p>Çështjet 5: Faqe 36</p> <p>Bazuar në analizat tona, kemi arritur në përfundim se prokurimet për kontratat e centralizuara nuk ishin planifikuar si duhet. Kjo kishte ndodhur kryesisht për shkak se ishin mbivlerësuar nevojat të cilat i kishin deklaruar shfrytëzuesit e paraparë të kontratave. AQP-ja nuk i kishte vërtetuar deklaratimet e tyre formalisht përmes Deklaratës së nevojave dhe Disponueshmërisë së mjeteve e cila shërben si mjet kontrolli në çdo prokurim publik, edhe në prokurimet me vlerë të vogël, por nuk ishte përdorë as në rastin e prokurimeve të centralizuara, ku kontratat kanë vlerë prej miliona eurove. Për pasojë katër kontrata të centralizuara nuk ishin realizuar siç ishin kontraktuar, bile as nuk e kishin arritur pragun e paraparë me ligj prej 70% të vlerës së kontraktuar. Megjithatë, mos realizimi i këtyre kontratave në nivel të pritshëm nuk kishte ndonjë pasojë financiare për AQP-në e as për shfrytëzuesit e kontratave të centralizuara (KC) sepse AQP kishte arritur marrëveshje miqësore me OE-të.</p>		<p>Konkluzioni kryesor këtu është paragrafi i fundit, kjo lidhet me objektivin e auditimit dhe me arritjen e vlerës për para, pasi që në pjesën e parë të auditimi keni gjetur që AQP do të dëmtoj buxheti për mbi 2 milion €, por kjo nuk ka ndodhur.</p> <p>Edhe pse në disa raste është e vërtet që ka vështirësi të planifikohen saktë nevojat sidomos për kontratat afatgjate por gjithsesi këto të gjetura duhet të ju adresohen institucioneve që nuk i kanë planifikuar mirë nevojat e tyre dhe assesi nuk është e gjetur për AQP-në përveç nëse kemi raste kur gabimi është i AQP-së, pasi që planifikimet e AQP-se për nevojat e veta janë shumë të arsyeshme dhe nuk kanë devijime në realizueshmëria e tyre.</p>	<p>Siç e kemi cekur në këtë raport, AQP ka kontaktuar dhe ka bërë “marrëveshje miqësore” pasi që Zyra Kombëtare e Auditimit në raportin e parë, ua ka tërhequr vëmendjen për pasojat e mundshme.</p> <p>Sipas RRUOPP - 8.1 AK do të inicioi një aktivitet të prokurimit vetëm pasi që të ketë kryer një vlerësim formal të nevojave, pse saktësisht nevojitet prokurimi. Qëllimi i vlerësimit paraprak të nevojave bëhet që të sigurohet që bëhen vetëm prokurime të sakta dhe të nevojshme, dhe të evitohet prokurimi jo-efikas si dhe të sigurohet që lëndët që i përmbushin këto nevoja nuk janë në dispozicion nga ndonjë autoritet tjetër publik.</p> <p>Deklarata e nevojave do të mund të kishte shërbyer si indikator se cilido institucion, e në rastin konkret KQZ, do të ketë nevojë për automjete vetëm për një periudhë të shkurtër kohore nëse Deklarata do të përmbante të dhënat mbi kilometrat e planifikuara të udhëtimit. Siç e kemi cekur edhe në raport, Deklarata e Nevojave shërben si mjet kontrolli në çdo prokurim publik, edhe në prokurimet me vlerë të vogël, e si mos të përdorët në rastin e prokurimeve të centralizuara, ku kontratat kanë vlerë prej miliona eurove dhe pasojat mund të jenë shumëfish më të mëdha se në prokurimet individuale.</p>

<p>Çështjet 6: Faqe 36.</p> <p>Aspekt tjetër i planifikimit të prokurimit që nuk ishte bërë siç duhet ishte hulumtimi jo adekuat i tregut. AQP-ja nuk kishte marrë parasysh kontratat individuale të shfrytëzuesve të kontratave të centralizuara, e as nuk kishte bërë hulumtim adekuat për çmime të tregut, duke e anashkaluar tërësisht si hap në proces. Për pasojë kishte sjellë disa kontrata të centralizuara që përmbanin disa artikuj me çmime më të larta krahasuar me çmimet e kontratave të pavarura. Kjo do të thotë se AQP nuk e kishte arritur tërësisht potencialin për kursim.</p>	JO	<p>Nuk pajtohem me këtë konkluzion pasi që AQP ka bërë hulumtimin e tregut dhe diskutime/mbledhje të dhënave nga institucionet që kanë kërkuar produktet e tilla për secilin aktivitet të prokurimit kur ai aktivitet realizohet për herë të parë ndërsa për aktivitet e ardhshme si bazë janë kontratat paraprake dhe gjithashtu edhe hulumtimi i tregut së bashku me diskutimet me njësit e kërkesës. Gjithashtu supozimi i juaj që nuk është arritur “potenciali për kursim” është vetëm supozim i bazuar në disa hipoteza që ligjërisht nuk mund të realizohen pasi që nuk lejohet ligjërisht.</p>	<p>Hulumtimi ka qenë i mangët, njësoj sikurse edhe analizat, sepse nuk keni marrë parasysh për të analizuar kontratat individuale të AK-ve.</p> <p>Këtë, përveç neve e ka konstatuar edhe raporti “Ndhimë teknike për mbështetjen e zbatimit të reformave për menaxhimin e financave publike në Kosovë” ku në faqe 4 thuhet “.... fusha kryesore që duhet të përmirësohet është hulumtimi i hollësishëm i tregut për të përcaktuar thellësinë dhe konkurrencën e furnizuesve të mundshëm kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar” si dhe “AQP ndoshta po siguron vlerë për para megjithatë kjo mund të përmirësohet duke bërë hulumtime të thella të tregut dhe duke përcaktuar çmime referuese.”</p>
<p>Çështjet 7: Faqe 36.</p> <p>Krahasimi i çmimeve të tri KC-ve në vlerë të përgjithshme prej 19,152,835 euro, me artikujt e kontratave individuale (KI) që ne kemi pasur mundësi t'i krahasojmë, ka rezultuar se totali i kursimeve të realizuara ishte 477,510 euro ndërsa iu kishte shkaktuar kosto shtesë prej 104,490 euro.</p>	JO	<p>Kjo sipas neve është e pasaktë pasi që kursimi nga këto tri kontrata sipas analizës tuaj është 477,510€, ndërsa kur ka kursime nuk mund të ketë kosto shtesë, ndonëse në të ardhmen duke avancuar edhe me tutje kontratat e centralizuara mund të rriten kursimet por assesi nuk mund një kontratë të ketë kursime dhe kosto shtesë në të njëjtën kohë.</p>	<p>Nuk do të ishte e drejtë të thuhet që KC ka arritur vetëm kursim kur dihet se ka OB që kanë pasur KI me çmime më të ulëta se çmimet e KC-ve.</p>

<p>Çështjet 8: Faqe 36.</p> <p>Sa përket furnizimit me letër, kontrata e centralizuar u kishte sjellë kursime disa shfrytëzuesve - gjithsej 27,178 euro, e disa tjerëve ju kishte sjellë shpenzime shtesë, gjithsej 27,856 euro. Në total kjo KC kishte sjellë 678 euro shpenzime shtesë për sasi të që kemi analizuar.</p>	JO	<p>Edhe tek institucionet që i keni marrë për krahasim kemi disa paqartësi pasi që nëse merret për analizë çmimi i KI të PK të cilin e keni vendosur në pjesën e parë të raportit atëherë kursimet te paraqitura sipas formës se draft raportit ne Tabelën 9 është mbi 300,000€ apo saktë 308,842.70€, gjithashtu nëse merret një mesatare në mes të këtyre dy çmimeve të cekura nga ju për PK atëherë kemi një çmim prej 3.94€/ris dhe kursimet në krahasim me KC sipas Tabelës 9 është mbi 150,000€. Ketu vërehen dallim të mëdha në çmimet e KI dhe per kete ju duhet të vlerësoni kohën se kur janë lidhur keto kontrata me çmimet e tregut në atë kohë.</p>	<p>Në raportin e parë është paraqitur çmimi i PK-së 5.5€/ris, mirëpo sasia e përafërt vjetore ishte 30 risa dhe ishte letër A4 80 g/m2 me ngjyra. Me kontratën pasuese të PK-së të lidhur në vitin 2016 - njëtin vit sikurse edhe KC që e kishte lidhur AQP - ishin kontraktuar 30,000 risë letër me çmim prej 2.26€ për ris.</p>
<p>Çështjet 9: Faqe 37.</p> <p>Ndërsa do të mund të kurseheshin edhe 544,306€ sikur e tërë sasia e furnizuar me kontrata të centralizuara të ishte blerë me çmimet më të lira të artikujve përkatës në secilën kontratë individuale. Kursim prej 317,543 euro që do realizohej sikur çmimi i kontraktuar i karburantit (premiumit) në KC të ishte i njëjtë me çmimin e kontratës paraprake të AQP-së, pastaj kursimi prej 75,247 euro që do realizohej sikur letra A4 të kishte çmim të njëjtë me çmimin e kontratës individuale të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe 151,516 euro do të mund të kurseheshin sikur çmimet e artikujve të caktuar të</p>	JO	<p>Ne pajtohemi që kontratat e centralizuara sjellin kursime sepse një gjë e tillë shihet edhe analizat e kryera nga AQP-ja por edhe në analizat e kryera nga GIZ i financuar nga Bashkimi Evropian. Por ju nuk mund të jepni konkluzione se sa është kursimi saktë kur nuk i keni analizuar të gjithë artikujt kjo do të thotë që ju nuk i keni analizuar të gjitha kontratat (këtu Ne nuk po paragjykojmë rezultatin nëse do të analizohen të gjitha kontratat në tërësi), gjithashtu vlen të ceket që AK-se nuk mund të ju përcaktoj çmimin me të cilin do të ofertojnë OE në kohë dhe rrethana të ndryshme dhe nuk mundet ti eliminoj OE nëse ofrojnë çmime më të larta në ndonjë artikull se në kontratat paraprake por që prapë oferta në tërësi është me çmim më të ulët se çmimi i tregut, por në çdo kohë AQP kujdeset që çmimet të jenë në nivel ose më ulët se çmimet e tregut. Si dëshmi këtu e keni që asnjëra KC si total nuk ka</p>	<p>Kursimi i konstatuar është i bazuar në metodologjinë e shpjeguar në aneks të raportit ku është thënë se janë krahasuar çmimet e një numri të caktuar të artikujve të kontratave të centralizuara (të zbatuara plotësisht) me çmimet e kontratave individuale të OB-ve (për shfrytëzuesit më të mëdhenj të kontratave të centralizuara). Krahasimi i të njëjtave është bërë edhe me çmimet e tregut (për aq sa kemi pasur mundësi të sigurojmë);</p>

materialit zyrtar të ishin të njëjta me çmimet më të ulëta të kontratave individuale.		çmime më të larta se çmimet e tregut nëse ju keni të dhëna tjera ju lutem ti bashkëngjitni ato.	
<p>Çështjet 10: Faqe 37.</p> <p>Kursimet, përkatësisht kostot shtesë të shkaktuara nga prokurimi i centralizuar, qoftë në raport me KI apo me çmimet e tregut, nuk ishin të njohura për AQP-në për shkak se AQP-ja, në mungesë të të dhënave bazuar në hulumtim adekuat të tregut, nuk kishte bërë analiza krahasuese për të gjetur se a ia vlen të vazhdohet me prokurim të centralizuar apo jo.</p> <p>Njësoj sikurse edhe në kontratat e para të centralizuara, AQP nuk kishte bërë analizën e kosto-përfitimeve që normalisht do duhej t'i paraprinte vendimit për inicim të prokurimit të centralizuar. Në bazë të konkluzionit të nxjerrë nga analiza do të duhej të merrej vendimi a të vazhdohet me prokurim të centralizuar apo jo. Në mungesë të kësaj analize, AQP-ja nuk ka njohuri mbi efektin që ka arritur prokurimi i centralizuar e për pasojë nuk ka njohuri se a është arritur vlerë për para apo jo.</p>	JO	<p>AQP kryen analiza të KC dhe i publikon në web faqen e AQP-së, ndërsa Ne konsiderojmë që ato analiza janë adekuate pasi që janë të kryera edhe nga palët e jashtme (GIZ) dhe është e evidentuar që është arritur vlera për para dhe nëse ju i konsideroni si jo adekuate atëherë duhet të ofroni formën tuaj se si është analiza adekuate. Edhe pse edhe në raportin tuaj si tërësi është arritur vlera për para.</p>	<p>AQP ka bërë analizën e pesë kontratave të centralizuara të cilat ishin në zbatim e sipër, ndërsa numri i kontratave të centralizuara për të cilat AQP nuk ka bërë analizë është shumë më i madh.,</p>

<p>Çështjet 11: Faqe 37.</p> <p>Për KC-në - furnizim me mish, njësoj sikurse edhe për kontratat e para të centralizuara, AQP-ja nuk e kishte hulumtuar tregun duke arritur në situatë kur kishte pranuar çmimet e ofertave ashtu siç kishin ardhur, pa e pasur një çmim referent real.</p>	JO	<p>Ky konkluzion është i pasaktë pasi që AQP ka bërë hulumtimet e tregut dhe ka komunikuar me njësit kërkuese gjatë përcaktimit të vlerës së parashikuar, këtu mund të shihni edhe të dhënat e publikuara nga ASK-ja të cilat i keni përdorur për analizën e furnizimit me karburante dhe të vlerësoni se vlera e parashikuar a ka qenë vlera e tregut, që të arrihet tek kjo vlerë janë vlerësuar çmimet e tregut dhe nuk ka qenë rastësi, ndërsa në kontratë kemi arritur çmime më të ulëta se çmimet e tregut dhe kjo nënkupton që është arritur vlera për para.</p>	<p>Për kontratën furnizim me mish, nuk na keni ofruar asnjë dëshmi që keni bërë ndonjë hulumtim tregu. Kontratat me të cilat ne i kemi krahasuar çmimet e KC-së i kemi siguruar direkt nga shfrytëzuesit e KC-së.</p>
<p>Çështjet 12: Faqe 38.</p> <p>Edhe pse AQP-ja si dhe çdo autoritet kontraktues janë liruar nga përgjegjësia për t'u furnizuar me +/-30% të vlerës/sasisë së kontraktuar si pasojë e gjendjes së shkaktuar nga pandemia Covid-19, në mungesë të këtyre informatave AQP-ja nuk do të jetë në gjendje të bëjë amandamentimin e KC-ve për t'iu përshtatur nevojave reale shfrytëzuesve të kontratave.</p>	JO	<p>Këtu e kemi shumë të paqartë se çfarë keni cekur. Kontratat kornizë të audituara nga ju janë të përfunduara dhe nuk mund të bëhet amandamentime, ndërsa kontratat afatgjate të shfrytëzimit të fotokopjeve dhe ato të veturave me qira janë kontrata afatgjate dhe jo kornizë. Andaj ky konkluzion Ne konsiderojmë që duhet të largohet nga raporti sepse nuk ka të bëjë më kontratat e audituara.</p>	<p>Ky paragraf i referohet monitorimit të kontratave që janë në zbatim e sipër dhe amandamentimit të tyre sipas nevojës, për shkak ndikimit të pandemisë.</p>
<p>Çështjet 13: Faqe 38.</p> <p>Gjithashtu AQP-ja nuk do të jetë në gjendje të konstatojë efektet qoftë pozitive apo negative të prokurimit të centralizuar e për pasojë do të vazhdojë</p>	JO	<p>Përkundrazi AQP është në gjendje të konstatoj efektet e kontratave të centralizuara dhe këto konstatime vijën nga analizat e AQP-së për kontratat e centralizuara që gjenden në web faqen e AQP-së të bëra edhe nga AQP-ja por edhe nga palët e jashtme dhe gjithashtu edhe nga raportet e auditimit.</p>	<p>AQP ka analizuar dhe publikuar një raport ku ka prezantuar "kursimet" për pesë kontrata, ndërsa numri i kontratave të centralizuara është shumë më i madh. Për më tepër është krahasuar totali i shpenzimeve dhe mënyra e kalkulimit të kursimit nuk është bindëse për shkak se keni krahasuar vlerën e parashikuar me çmimin e kontratës. Cilido AK, edhe me prokurim</p>

<p>të zhvillojë prokurime, efekti i të cilave është i panjohur.</p>			<p>individual, arrin që çmimin e kontratës ta ketë më të ulët se vlerën e parashikuar të kontratës.</p>
<p>Çështjet 14: Faqe 38.</p> <p>Edhe Ministria e Financave, si autoritet për miratim ose jo të prokurimeve të centralizuara, nuk do të jetë në gjendje të marr vendime të duhura në mungesë të informacionit të besueshëm e të bazuar në fakte.</p>	<p>JO</p>	<p>Ky nuk është konkluzion por është supozim i pabazuar pasi që MFPT propozon në Qeveri listën e artikujve për përdorim të përbashkët pas propozimit nga AQP-ja, propozimin AQP-ja e dorëzon sipas propozimit të një grupi punues i cili bazohet në planifikimet e AK-se dhe kërkesave të tyre gjithsesi para miratimit MFPT dhe gjithashtu Qeveria kryen analizat e veta, kështu që ky supozim i juaji duket i pabazë dhe i drejtuar në mënyrë jo të duhur.</p>	<p>Çdo vendimmarrje duhet të bazohet në informata të plota dhe të sakta, , e në rastin e KC-ve, meqë raportet e zbatimit të kontratave nuk ishin analizuar për shkak të monitorimit të mangët, informata është e mangët. Prandaj propozimet nga AQP në MFPT nuk do të ishin të bazuara në analiza të mirëfillta.</p>
<p>Çështjet 15: Faqe 39.</p> <p>Rekomandimet</p>		<p>Sa i përket Rekomandimeve të draft raportit AQP do ti ketë parasysh të gjitha ato, por duke u bazuar në atë që ju në këtë raport keni kryer analiza të disa kontratave të centralizuara Ne besojmë që ju duhet të jepni rekomandime se në bazë të arritjes apo jo të vlerës për para a duhet të zhvillohen edhe në të ardhmen procedurat e centralizuara apo jo për kontratat e paraqitura në raport.</p>	<p>Auditimet e performancës të ndërmarra nga Zyra Kombëtare e Auditimit janë shqyrtime objektive dhe të besueshme që vlerësojnë nëse veprimet qeveritare, sistemet, operacionet, programet, aktivitetet ose organizatat veprojnë në përputhje me parimet e ekonomisë, efikasitetit dhe efektivitetit dhe nëse ka vend për përmirësim.</p> <p>Vendimi për zhvillim apo jo të prokurimeve të centralizuara i takon AQP-së. Për pikënisje mund të ju shërbejnë analizat si dhe rekomandimet që janë prezantuar në këtë raport..</p>